


BULETINI PERIODIK

JANAR-SHKURT 2026



Buletini periodik i vendimmarrjes
Nr. 1, janar-shkurt 2026
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë





HYRJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës janar-shkurt 2026.

PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative.....	4
Konflikt i kompetencave mes pushteteve	9
Ankim kushtetues individual ...	12



Garancitë e nenit 138 të Kushtetutës – Paprekshmëria e pagës së gjyqtarit – Diskrecioni i ligjvënësit në rregullimin e pagës së magjistratëve

FJALË KYÇE

Paketa e reformës në drejtësi/ pagë referuese bazë/ pagë për funksion/ rekomandimi i KLSH-së/ koeficient i pagës/ përshtatshmëri e pagës me funksionin/ ulje e fshetë/ ulje e shënjestruar/ ngrirje e pagës/ indeksim i pagës

Në kuptim të nenit 138 të Kushtetutës parimi i përshtatshmërisë së pagës kërkon që ajo të jetë në atë masë që të sigurojë një nivel të përshtatshëm me detyrën dhe funksionin, për rrjedhojë kërkon edhe që paga të zhvillohet dhe të ecë në të njëjtën linjë me zhvillimet ekonomike e financiare dhe vetë standardin e jetesës në vend, por sigurisht, duke u përshtatur edhe me situatën financiare të shtetit.

“Ngrirja e pagës” në një kontekst të caktuar mund të përbëjë “ulje të fshetë të pagës”, përtej rasteve të parashikuara shprehimisht në këtë dispozitë.

Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë *Ndryshimet ligjore në formulën e pagës së magjistratëve* **Vendimi nr. 15, datë 17.02.2026**

Faktet

Në vitin 2016 u miratua paketa e reformës në drejtësi, pjesë e së cilës është edhe ligji nr. 96/2016, datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili, në nenin 12, pika 5, përcakton elementet përbërëse të pagës mujore bruto të magjistratëve. Shkronja “a” e kësaj dispozite në formulimin fillestar parashikonte se, paga referuese bazë ishte e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të. Zbatimi i kësaj skeme filloi pas datës 01.01.2019. Pas rekomandimit të vitit 2021 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zbatimi i kësaj norme u korrigjua, me pasojë rritjen e pagës.

Me ligjin nr. 50/2021, datë 23.03.2021, Kuvendi ndryshoi formulën e pagës referuese bazë të magjistratëve, duke referuar te “shtesa për pozicion” e pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri, dispozitë që u shfuqizua nga Gjykata me vendimin nr. 35/2022, pasi binte ndesh me nenin 138 të Kushtetutës. Pas këtij vendimi, Kuvendi, me ligjin nr. 33/2023, datë 25.05.2023, ndërhyri në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016 duke parashikuar se paga referuese bazë “është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës”. Po kështu u parashikua edhe indeksimi i saj me VKM. Unioni i Gjyqtarëve iu drejtua Gjykatës për kundërshtimin e dispozitave të ligjit nr. 33/2023.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e nenit 138 të Kushtetutës

Gjykata, në funksion të analizës së çështjes, evidentoi standardet kushtetuese të zbatueshme, si dhe u ndal në analizën e konceptit “diskrecion i ligjvënësit” në rregullimin e pagës së magjistratëve, duke evidentuar kriteret që duhet të mbahen në konsideratë nga ligjvënësi: i) rregullat themelore të pagës duhet të përcaktohen “me ligj”, jo me vendime diskrecionale subjektive e të ndryshueshme; ii) verifikimi i situatave që u përkasin rasteve përjashtimore të nenit 138 i Kushtetutës. Në këtë kuptim, koncepti “ulje page” sipas nenit 138 të Kushtetutës, përfshin jo thjesht uljen numerike (të vlerës absolute), por edhe uljet e synuara ose të shënjestruara, që vijnë nga përdorimi i instrumenteve me “elemente diskrecionale” e me karakter subjektiv, siç janë rastet kur paga nuk është më e aftë të ofrojë të njëjtin standard jetese dhe as nuk përshtatet më me rëndësinë e funksionit; iii) paga nuk mund të rrijë “e ngrirë” në kushtet e inflacionit, sidomos për periudha të gjata.

Në kuptim të këtyre standardeve dhe parimeve, Gjykata vlerësoi se në rastin konkret dukej se plotësohej kriteri i parë dhe i tretë. Në lidhje me kriterin e dytë, ajo shqyrtoi nëse formula e pagës respekton garancitë e nenit 138 të Kushtetutës në drejtim të përshtatshmërisë me detyrën dhe ndalimit të uljeve të fshetë. Pavarësisht rritjes së pagës së referencës, si sipas formulës fillestare, ashtu edhe asaj aktuale, duket se paga e magjistratëve qëllimisht u la në nivelin e pagës që rezultoi sipas interpretimit të normës së mëparshme ligjore me vendimin nr. 35/2022 të Gjykatës, që ajo, po në dukje, të mos të ulej në vlerë absolute, pra të ngrinte në mënyrë të shënjestruar, çka, në thelb, përbën ulje të fshetë. Mosndryshimi i pagës së magjistratëve, jo si ngjarje e izoluar, por duke pasur parasysh kohën e konsiderueshme nga zbatimi i formulës së re, kontekstin socio-ekonomik të vendit që ka pësuar ndryshime të ndjeshme, pasi janë rritur standardi i jetesës, fondet publike dhe pagat e punonjësve të tjerë, së bashku me faktin që referenca ndryshoi në mënyrë të tillë që të dyja pagat zyrtare referenciale u ndryshuan në mënyrë domethënëse përmes spostimit në kohë të miratimit të ndryshimeve ligjore përkatëse, nxjerrin përfundimin se mosndryshimi i pagës së gjyqtarit përbën ulje të fshetë të shënjestruar. Metoda e përdorur në vitin 2023 përbën “ulje të fshetë” të pagës, për sa i përket përfuturimit që rrjedh nga formulimi origjinal i nenit 12 të ligjit nr. 96/2016.

Ndonëse rezultati në vlera financiare absolute i pagës së magjistratëve nuk është më i ulët sesa ai i prodhuar nga formula e mëparshme, formula e kundërshtuar, në raport me rritjen ekonomike dhe rritjen e çmimeve, përbën në vetvete një ulje të fshehur dhe të shënjestruar të pagës, duke e ngrirë atë për gati 10 vjet që prej vitit 2016, kur është miratuar për herë të parë, deri në vitin 2026, kur u bë indeksimi i parë.

Mospërputhja midis zhvillimit të pagave të magjistratëve dhe zhvillimit të pagave të tjera në shërbimin civil publik, përkthehet në ulje të fshehtë dhe të shënjestruar të pagës së magjistratëve.

Ndonëse rezultati në vlera financiare i prodhuar nga formula e re nuk është më i ulët se ai i prodhuar nga formula e mëparshme, nuk respektohet parimi i përshtatshmërisë së pagës, që kërkon që shpërblimi financiar i magjistratëve, në kontekstin e situatës ekonomike, sociale dhe financiare të vendit, të garantojë pavarësinë ekonomike të pajtueshme me përgjegjësitë e detyrës dhe dinjitetin e funksionit për t'i mbrojtur nga çdo ndërhyrje ose presion i jashtëm gjatë ushtrimit të detyrës, i konsideruar si një element kyç në luftën kundër korrupsionit. Duke mos qenë përpara asnjërit prej rasteve përjashtimore sipas nenit 138 të Kushtetutës dhe për sa kohë ka një mospërputhje midis zhvillimit të pagave të magjistratëve dhe zhvillimit të pagave të tjera në shërbimin civil publik, kjo përkthehet në ulje të fshehtë dhe të shënjestruar të pagës së magjistratëve.

Ndonëse neni 138 i Kushtetutës nuk përcakton pragun/kufirin ose kriteret treguese për të vlerësuar përshtatshmërinë e nivelit të pagës së magjistratëve, ligjvënësi duhet ta përshtasë atë me zhvillimin e kushteve të përgjithshme ekonomike të vendit, në një periudhë kohore të caktuar dhe në raport edhe me zhvillimin e pagave të referencës ashtu edhe të funksionarëve të tjerë publikë.

Vendimarrja

Gjykata, me shumicë votash, vendosi, pranimin pjesërisht të kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim pakice) .



**Parimi i demokracisë
përfaqësuese – Liria e
shprehjes së deputetit**

FJALË KYÇE

*Rregullore e Kuvendit/ Shqyrtimi i
përshpejtuar i projektakteve/
Mënyra e thirrjes së mbledhjes/
pakica parlamentare/ mandat
përfaqësues/ e drejta e fjalës së
deputetit/ luajjalitet kushtetues*

**Afatet e thirrjes së
mbledhjes (seancës plenare)
nuk janë thjesht formale, por
përbëjnë garanci që
mbledhjet e deputetëve të
thirren sipas Rregullores, me
qëllim ushtrimin e matur dhe
në respektim të të drejtave
të deputetëve të
veprimtarisë parlamentare.**

**Pa komunikimin e
projektakteve, realizimi i të
drejtave të tjera të
anëtarëve të Parlamentit, siç
është ajo për të paraqitur
propozime dhe
amendamente alternative, si
dhe për të debatuar mbi
projektaktin, bëhet iluzore.**

**Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit
të Republikës së Shqipërisë**

*Procedura parlamentare për miratimin e ndryshimeve
në Rregulloren e Kuvendit*

Vendimi nr. 18, datë 23.02.2026

Faktet

Një grup prej pesë deputetësh, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, propozuan disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, të miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004.

Në seancën plenare të datës 16.09.2025, Kuvendi, mbi kërkesën e 30 deputetëve vendosi të shqyrtojë propozimin me procedurë të përshpejtuar të ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit në seancën plenare të po asaj dite. Me vendimin nr. 57/2025, datë 16.09.2025, Kuvendi miratoi ndryshimet në vendimin e tij nr. 166/2004, konkretisht në pikën 1, të nenit 19, të Rregullores, duke ndryshuar numrin e komisioneve të përhershme të Kuvendit nga 8 në 11, me emërtimet dhe fushat e përgjegjësisë së tyre, si dhe në nenin 20 të Rregullores, ku u shfuqizua pika 3 që parashikonte mundësinë e anëtarëve të Komisionit të Integritetit Evropian për të qenë anëtarë edhe në komisione të tjera. Në datën 23.09.2025, kërkuesi, një grup prej 39 deputetësh iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin edhe pezullimin e vendimit nr. 57/2025, të Kuvendit. Me vendimin e datës 03.12.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të aktit si të pabazuar.

Vlerësimi i Gjykatës


Për juridiksionin e Gjykatës – Pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë, në thelb, me kufizimin e ushtrimit të të drejtave të deputetëve që burojnë nga mandati i tyre kushtetues përfaqësues, në kuptim të neneve 70 dhe 71 të Kushtetutës. Për sa kohë këto pretendime lidhen me cenimin e të drejtave që burojnë nga normat kushtetuese, dispozitat e Rregullores objekt shqyrtimi përfshihen në juridiksionin kushtetues.

Për cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes – Pretendimi për cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në këndvështrim të lirisë së shprehjes është mbështetur në dy aspekte kryesore të procedurës parlamentare: (i) mënyra e thirrjes së Kuvendit, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës; (ii) shpejtësia e procedurës, në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës. Gjykata, verifikoi mënyrën e zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale që rregullojnë këto aspekte të procedurës parlamentare, për të arritur në përfundimin, nëse është cenuar parimi i demokracisë përfaqësuese.

Për mënyrën e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare - Neni 78, pika 2, i Kushtetutës është dispozitë referuese në dispozitat e Rregullores lidhur me mënyrën dhe procedurën e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare dhe plotësohet edhe nga neni 27/1 i Rregullores, që përcakton mënyrën e thirrjes së seancës dhe afatet e saj. Shkelja e kësaj dispozite materializohet me pavlefshmërinë e vetë mbledhjes. Referuar procedurës së ndjekur në rastin konkret, mbledhja e deputetëve është thirrur në të njëjtën ditë me paraqitjen e propozimit nga deputetët propozues dhe vetëm një ditë përpara seancës plenare, duke u lajmëruar deputetët nëpërmjet e-mail-it nga administrata e Kuvendit. Deputetët e pakicës nuk rezultojnë të kenë marrë dijeni për projektvendimin e depozituar dhe janë njohur me aktin vetëm në momentin e shqyrtimit të kërkesës për miratimin me procedurë të përshpejtuar të propozimeve, pra ditën që ky akt është miratuar. Po kështu, lajmërimi për ndryshimin e rendit të ditës (ku ishte futur ndryshimi i Rregullores me procedurë të përshpejtuar) ishte bërë më pak se 24 orë nga zhvillimi i saj dhe pa iu vënë në dispozicion deputetëve ndryshimet konkrete, duke bërë që ata të njiheshin në seancë plenare me projektvendimin.

(vijon në faqen 7)

KONTROLL I AKTEVE NORMATIVE



Mënyra sesi është vepruar për thirrjen e seancës plenare ka vënë në pamundësi deputetët, veçanërisht ata të pakicës parlamentare, për të ushtruar lirisht të drejtat që u burojnë atyre nga statusi i deputetit. Kjo sjellje, në rastin konkret, ua ka pamundësuar deputetëve të drejtën për të diskutuar dhe debatuar për çështjet e propozuara për ndryshim dhe për të paraqitur amendamente në lidhje me to, për sa kohë që pretendimet në lidhje me çështjet e procedurës parlamentare edhe pse u lejuan të ngrihen formalisht në thelb nuk u dëgjuan dhe nuk u morën në konsideratë, duke ua pamundësuar deputetëve të pakicës parlamentare të votojnë në mënyrë të informuar. Mënyra e veprimit të Kuvendit nuk është bërë në përputhje me parimin e luajalitetit kushtetues, duke sjellë cenimin e parimit të demokracisë kushtetuese.

Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit me procedurë të përshpejtuar –

Në referim të nenit 117 të Rregullores, parashikimi i pikës 2 të nenit 83 të Kushtetutës është shterues lidhur me llojin e akteve që i nënshtrohen shqyrtimit të përshpejtuar, duke përfshirë edhe projektvendimin për ndryshimin e Rregullores. Pas rinisjes së seancës plenare, pakicës parlamentare i është dhënë mundësia e diskutimit në seancë lidhur me procedurën, ndërkohë që në diskutim janë përfshirë 15 deputetë të pakicës dhe disa deputetë të shumicës parlamentare të cilëve iu është dhënë fjala për procedurë, por jo për thelbin e ndryshimeve. Ndryshimi Rregullores, për vetë rëndësinë që përfaqëson, është barazuar nga vetë Kuvendi me procesin e shqyrtimit të projektligjeve në të gjitha aspektet që e karakterizojnë atë, përfshirë këtu të drejtën e debatit për thelbin e ndryshimeve, sikundër atë për paraqitjen e amendamenteve nga deputetët. Nga njëra anë, kjo liri dhe mënyra e ushtrimit të saj në përputhje me parashikimet e Rregullores nuk mund të lihet në diskrecionin ose interpretimin e Kryetarit të Kuvendit. Kufizimi i së drejtës së fjalës ose heqja e saj deputetëve të pakicës parlamentare nga Kryetari i Kuvendit, që ka sjellë pamundësinë e ushtrimit në një kohë të arsyeshme të të drejtave të tyre kushtetuese, vlerësohet edhe se është në tejkalim të kompetencave të tij funksionale dhe bie ndesh me nenet 70, pika 1 dhe 75, pika 2, të Kushtetutës. Nga ana tjetër votimi me procedurë të përshpejtuar për miratimin e dispozitave të Rregullores, pa u dhënë deputetëve të pakicës parlamentare mundësinë për t'u njohur paraprakisht me përmbajtjen e projektvendimit, tejkalon diskrecionin e Parlamentit në organizimin e procedurave parlamentare dhe nuk arrin një ekuilibër të drejtë midis parimit të autonomisë parlamentare dhe atij të demokracisë përfaqësuese. Me qëllim që deputetëve t'u sigurohet mundësia për t'u njohur me përmbajtjen e projektakteve të Parlamentit, atyre duhet t'u jepet një periudhë e arsyeshme kohore, për t'i analizuar dhe për të formuar një mendim mbi to. Mënyra e thirrjes së Kuvendit në seancë plenare, si dhe procedura e përshpejtuar e miratimit të ndryshimeve të Rregullores kanë sjellë cenimin e parimit të demokracisë përfaqësuese në drejtim të lirisë së shprehjes së deputetëve të pakicës parlamentare.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 57/2025, datë 16.09.2025 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (një gjyqtar u shpreh me mendim paralel). Efektet shfuqizuese të këtij vendimi hyjnë në fuqi 30 ditë nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

DECISIONS OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA 1998-2011

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1993-2015

VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1993-2015

**VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 2012**

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1922-2022**



Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve – Regjimi i imuniteteve të anëtarit të Këshillit të Ministrave

FJALË KYÇE

Konflikt kompetencash / kompetenca kushtetuese / subjekte kushtetuese / interpretim i dispozitës kushtetuese / masë sigurimi personal / pezullimi nga detyra i funksionarit publik / ministër / sovranitet/ imunitet / përgjegjësi politike

Ndërmjet Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave nga njëra anë dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë nga ana tjetër ka lindur një mosmarrëveshje konkrete kompetencash kushtetuese për shkak të vendosjes nga kjo e fundit të masës së sigurimit personal me karakter ndalues të pezullimit nga detyra të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të një procedimi penal.

Neni 242, pika 2, i KPP-së, që ndalon zbatimin e masës së pezullimit nga detyra ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral përbën garanci të veçantë procedurale për këta funksionarë dhe lidhet me mbrojtjen e funksionit përfaqësues, si dhe me respektimin e parimit të sovranitetit popullor. Kjo garanci nuk mund të interpretohet si një zgjatim i regjimit të imunitetit përtej kufijve kushtetues.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë
Konflikti i kompetencave midis Kryeministrit e Këshillit të Ministrave dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë për shkak të vendimit të pezullimit nga detyra të anëtarit të Këshillit të Ministrave

Vendimi nr. 8, datë 06.02.2026

Faktet

Në kuadër të një hetimi penal, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë në GJKKO-në e Shkallës së Parë, ndër të tjera, për caktimin e masës së sigurimit personal me natyrë ndaluese, “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, (të parashikuar nga neni 242 i KPP-së) ndaj Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, njëkohësisht deputete e Kuvendit. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata, e cila më pas ka vendosur vijimin e zbatimit të kësaj mase.

Në vijim, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar ndërmjet Kryeministrit e Këshillit të Ministrave dhe GJKKO-së së Shkallës së Parë, si pasojë e vendimeve gjyqësore, shfuqizimin e tyre dhe interpretimin e nenit 103, pika 3, të Kushtetutës në kuptimin që anëtari i Këshillit të Ministrave, duke gëzuar imunitetin e deputetit, përfiton nga të gjitha garancitë procedurale, që i njeh jo vetëm Kushtetuta këtij të fundit, por edhe legjislacioni procedural penal.

Në shqyrtimin paraprak të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

Vlerësimi i Gjykatës

Për juridiksionin

Gjykata konstatoi se, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave, si organe kushtetuese të pushtetit ekzekutiv, dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si organ kushtetues i pushtetit gjyqësor – janë subjekte të parashikuara nga Kushtetuta dhe ushtruese të kompetencave të përcaktuara prej saj. Ndonëse Kushtetuta nuk parashikon shprehimisht një kompetencë të Kryeministrit ose të ndonjë organi tjetër për pezullimin nga detyra të një ministri, masa ndaluese e vendosur nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në kuadër të një procedimi penal, për nga natyra dhe efektet e saj konkrete, duket se ka sjellë efekte institucionale, si në ushtrimin e funksioneve kushtetuese të ministrit, ashtu edhe në funksionimin e Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se paraqitet në dukje një mosmarrëveshje konkrete kompetencash kushtetuese ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, e cila hyn në juridiksionin kushtetues.


Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se kërkuesi legjitimohet për t’iu drejtuar asaj me kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe rrjedhimisht interpretimin përfundimtar të dispozitës kushtetuese.

Për regjimin e imuniteteve të ministrit në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve - Gjykata vërejt se neni 103, pika 3, i Kushtetutës parashikon se anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit. Përderisa kjo dispozitë kushtetuese e trajton imunitetin e ministrit si të njëjtë me atë të deputetit, analiza e regjimit të këtij imuniteti kërkon referimin në nenin 73 të Kushtetutës, ku përcaktohet natyra dhe shtrirja e imunitetit parlamentar.

Gjykata vlerësoi se rregullat e parashikuara në nenin 73 të Kushtetutës janë të zbatueshme edhe për ministrin dhe përbëjnë regjimin kushtetues të imunitetit të tij. Meqenëse vetë Kushtetuta e barazon në aspektin substancial gëzimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave me imunitetin e deputetit, edhe procedura që ndiqet për heqjen e imunitetit të deputetit, e parashikuar në nenin 73 të saj, do të jetë e zbatueshme dhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është deputet. Megjithatë, imuniteti i ministrit nuk përbën një privilegj individual ose një formë mbrojtjeje absolute ndaj juridiksionit penal, por një garanci funksionale të kufizuar, e cila synon të sigurojë ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës.

(vijon në faqen 10)

KONFLIKT I KOMPETENCAVE MES PUSHTETEVE



Gjykata theksoi se, ndonëse ndaj ministrave parashikohet një regjim i veçantë imuniteti, ky i fundit ka si qëllim vetëm garantimin e ushtrimit të lirë dhe të pavarur të funksionit publik, duke i mbrojtur ata nga ndërhyrje ose sulme të padrejta me natyrë politike. Ai nuk mund të interpretohet si një mburojë ndaj zbatimit të ligjit penal, pasi ministri, si çdo individ, mbetet subjekt i përgjegjësisë penale dhe është i detyruar t'u nënshtrohet rregullave dhe sanksioneve penale përpara organeve kompetente në rast të kryerjes së një veprë penale.

Për garancitë e tjera procedurale në këndvështrim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve - Gjykata vlerësoi se dispozita ligjore e nenit 242, pika 2, i KPP-së, për nga natyra e saj, përbën një përjashtim të karakterit procedural, i cili nuk gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në tekstin kushtetues për sa u përket deputetëve ose ministrave.

Gjykata theksoi se një normë ligjore nuk mund të shërbejë si burim për t'i dhënë përmbajtje ose për të zgjeruar kuptimin e një norme kushtetuese përkundrazi, është norma kushtetuese ajo që përcakton kuadrin dhe kufijtë brenda të cilëve duhet të interpretohet dhe zbatohet legjislacioni i zakonshëm. Për rrjedhojë, dispozita e mësipërme nuk mund të konsiderohet pjesë e regjimit kushtetues të imunitetit, i cili është i përcaktuar në mënyrë shteruese nga Kushtetuta.

Në lidhje me objektin e kërkesës, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje.

Sipas njërës qëndrim, pavarësisht se në kuptimin kushtetues regjimi i imuniteteve nuk përbën përjashtim/mbrojtje nga ndjekja penale, ai nuk mund të kuptohet i shkëputur nga garancitë që lidhen me funksionin kushtetues në fjalë, pra ushtrimin e lirë dhe të pavarur të detyrës. Vendosija e masës së pezullimit nga detyra ndaj një anëtarit të Këshillit të Ministrave (ministrit), e cila nuk parashikohet shprehimisht nga Kushtetuta, për nga natyra dhe intensiteti i saj përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në ushtrimin e detyrës së tij.

Balancimi ndërmjet interesit publik për ndjekje penale efektive e ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe atij për garantimin e funksionimit efektiv të pushtetit ekzekutiv kërkon detyrimisht ndërmjetësimin e Kuvendit, nëpërmjet autorizimit paraprak të tij, gjë që nuk buron nga zgjerimi i regjimit të imuniteteve përtej vullnetit të kushtetutëbërësit, por rrjedh nga nevoja për të ruajtur ekuilibrin kushtetues ndërmjet pushteteve dhe për të garantuar që ndërhyrja në përbërjen dhe funksionimin e pushtetit ekzekutiv (qeverisë) të mos realizohet pa pjesëmarrjen e vetë organit që mban përgjegjësinë politike për të.

Sipas qëndrimit tjetër, çështja konkrete nuk mund të zgjidhet as vetëm përmes interpretimit të izoluar të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës dhe as nëpërmjet interpretimit të zgjeruar evolutiv të tij, që krijon një normë të re kushtetuese. Masa e pezullimit nga ushtrimi i detyrës publike, sipas nenit 242, të KPP-së, ndaj një ministri nuk mund të kërkojë autorizim paraprak të Kuvendit dhe nuk përfshihet në garancitë e imunitetit, pasi: a) nuk përfshihet në listën e masave të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës; b) normat për imunitetin interpretohen ngushtë dhe nuk lejojnë zgjerim ose krijim të normave të reja nëpërmjet interpretimit; c) arkitektura aktuale kushtetuese ofron garanci të mjaftueshme kundër ndjekjes penale arbitrare për motive politike; ç) efektet faktike për ushtrimin e funksionit nuk synojnë institucionin, por individin që dyshohet se nëse vijon kryerjen e detyrës mund të dëmtojë rëndë hetimin penal dhe nuk përbëjnë, në vetvete, cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës dhe heqjen e masës së pezullimit të caktuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 (dy gjyqtarë u shprehën edhe me mendim paralel).





**Parimi i sigurisë juridike -
Parimi i barazisë përpara
ligjit – E drejta për punë**

FJALË KYÇE

*Ndihmës ligjor/ subjekte ex officio/
pagë referuese/nëpunës civilë
gjyqësorë/ ndryshime në legjislacion/
mosndryshim i një situate të favorshme
ligjore/pritshmëri të ligjshme*

Gjykata ka evidentuar, se dispozitat e ligjit nr. 98/2016, i referohen edhe ndihmësve ligjorë që do të pranohen rishtas në këtë detyrë, ndërkohë që për sa u takon atyre që ndryshimet ligjore i kapën në detyrë, siç është edhe rasti i kërkuesve, ligjvënësi nëpërmjet nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, kishte parashikuar një garanci tjetër, siç ishte edhe mundësia për të vazhduar karrierën e magjistratit. Në rast se nuk do të ndiqej karriera e magjistratit, atëherë kësaj kategorie i garantohej një pozicion si ndihmës ligjor me status nëpunësi civil sipas ligjit nr. 98/2016, duke i siguruar në këtë mënyrë edhe të drejtën për punë, sipas statusit ligjor të ndryshuar.

Në këtë kuptim, ndryshimet ligjore të sjella me ligjin nr. 98/2016 kanë ardhur si nevojë reale dhe janë bërë në interes publik, pasi bëjnë të mundur që ndihmësit ligjorë të shtrihen në të gjitha gjykatat e faktit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, duke synuar lehtësimin e punës së gjyqtarëve, në një numër shumë herë më të madh nga më parë dhe njëkohësisht duke

Majlinda Miska, Jurgen Selimi

Për mosndryshmin e pagës së ndihmësve ligjorë

Vendimi nr. 1, datë 14.01.2026

Faktet

Kërkuesit, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, janë emëruar sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, e sipas nenit 6/2 të tij paguheshin sa 75% e pagës së gjyqtarit të gjykatës ku ushtronin funksionin. Me ligjin nr. 39/2017, u shfuqizuan disa dispozita të ligjit nr. 49/2012, ku përcaktoheshin kompetencat, kriteret për emërimin dhe pagesa e ndihmësve ligjorë të gjykatave administrative. Nga viti 2019 paga e tyre u përshtat me pagat e gjyqtarëve të ndryshuara sipas vendimit të Gjykatës nr. 34/2017. Ndërkohë që referuar dispozitave të ligjit nr. 98/2016, pas pranimit/caktimit në një pozicion si ndihmës ligjorë në shërbimin civil gjyqësor, sipas vendimeve të KLGJ-së, ata paguhën me pagën e funksionit të drejtorit të drejtorisë në ministri. Rezulton se ata i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar si subjekte *ex officio* dhe e kanë kaluar me sukses atë duke u bërë subjekt i përcaktimeve të nenit 64 të ligjit nr. 98/2016. Me pretendimin se parashikimi i kësaj dispozite ka sjellë pasoja negative në të drejtat e tyre, për shkak se ata trajtohen me një pagë më të ulët se ajo që kanë përfitur deri në caktimin në këtë pozicion, si dhe faktin që detyrat e tyre janë të ngjashme me ato të këshilltarëve ligjorë në Gjykatë ose Gjykatë të Lartë, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 6, të nenit 64, të ligjit nr. 98/2016, si e papajteshme me Kushtetutën.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të barazisë para ligjit – Gjykata vërejt se njësitë e këshillimit ligjor ligjvënësi i ka rezervuar për dy gjykatat më të larta nga pikëpamja hierarkike dhe për prokurorinë më të lartë të juridiksionit të zakonshëm, çka nënkupton se kemi të bëjmë me njësi të specializuara, të cilat u përgjigjen kompetencave, detyrave të këtyre organeve, si dhe në veçanti shkallës hierarkike. Duke marrë në analizë kompetencat dhe detyrat e këtyre njësive, Gjykata konstatoi se kompetencat e njësive të këshillimit ligjor janë më të gjera se ato të ndihmësve ligjorë, duke ofruar një ekspertizë më të thelluar. Gjithashtu, numri i këshilltarëve është më i kufizuar, e për më tepër edhe kompleksiteti i punës së këshilltarëve ligjorë, për shkak të juridiksionit dhe shkallës hierarkike që ato institucione kanë, është shumë më kompleks. Gjykata gjithashtu vërejt se edhe kriteret e punësimit për të dyja kategoritë janë të ndryshme, ku ato për këshilltarë ligjorë rezultojnë kriteret shumë më të forta nga pikëpamja cilësore. Gjykata ka vlerësuar se për sa kohë që nuk gjendemi përpara dy kategorive të njëjta të nëpunësve, të cilat kanë trajtim të ndryshëm, por përpara dy kategorive të ndryshme, të cilat trajtohen në raport me rëndësinë dhe kompleksitetin e detyrave që kryejnë, nuk rezulton që neni 64, pika 6, fjalia e dytë, i ligjit nr. 98/2016 të ketë cenuar parimin e barazisë përpara ligjit.

Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për punë - Gjykata vërejt se, në kushtet kur dispozitat e ligjit nr. 98/2016, e kategorizojnë ndihmësin ligjor si nëpunës civil gjyqësor, edhe paga e tij do të kategorizohet sipas akteve që normojnë pagën sipas statusit të nëpunësit civil. Duke qenë se rregullimi i vjetër ligjor për ndihmësit ligjorë si pranë gjykatave administrative, ashtu edhe pranë Gjykatës së Lartë u zëvendësua me një rregullim tërësor të ri, që solli për këtë kategori punonjësish të drejta dhe garanci të reja, e njëkohësisht u shoqërua edhe me ndryshimin e bazës për llogaritjen e pagës, nuk evidentohet cenim i parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për punë.

Gjykata vlerësoi se, pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për punë është i pabazuar, pasi dispozita është formuluar qartë dhe në harmoni me dispozitat e tjera të ligjit që normojnë kategorinë e ndihmësve ligjorë. Për sa i takon pretendimit se kjo dispozitë përkeqëson situatën e pagesës ndaj kërkuesve dhe kategorisë së ndihmësve ligjorë që ishin në detyrë në momentin e ndryshimeve në legjislacion, ato janë të pabazuara, pasi parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore, pasi ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast, e sidomos kur marrëdhënia e punësimit pëson ndryshim thelbësor.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.



E drejta për të mos iu nënshtruar trajtimi çnjerëzor dhe/ose degradues – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor – Standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese – E drejta për të mos u dëbuar

FJALË KYÇE

Shtetas rus/ kërkim ndërkombëtar/ kërkesë për azil/ ekstradimi/ Konventa për Ekstradimin/ pezullim i ekstradimit/ me vendim të Gjykatës Kushtetuese/ dorëzim i të ekstraduarit/ dëbim i të huajit/ amicus curiae/ viktimë e shkeljes kushtetuese/ garanci të përgjithshme të kërkesës për ekstradim

Garancitë e dhëna nga shteti kërkues për garantimin e të drejtave themelore të kërkuesit nuk i çlironin autoritet shqiptare nga detyrimi për të bërë një vlerësim të pavarur dhe të plotë të ekzistencës së rreziqeve aktuale në këtë drejtim.

Igor Kokunov

Procedura e ekstradimit të shtetasit të huaj

Vendimi nr. 2, datë 14.01.2026

Faktet

Kërkuesit, shtetas rus, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Moska pasi u ndalua në territorin shqiptar, iu caktua masa “Arresti në burg” nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me qëllim ekstradimin e tij. Në datën 18.09.2023, autoritetet ruse paraqitën kërkesën për ekstradimin e kërkuesit. Mbi kërkesën e Prokurorisë së Shkodrës, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër vendosi lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Federatën Ruse. Mbi ankimin dhe rekursin e kërkuesit, gjykatat më të larta lanë në fuqi ekstradimin. Gjithashtu dhe kërkesa e tij për azil në Shqipëri nuk u pranua, pasi u konsiderua si mjet për bllokim të ekstradimit.

Pasi ishte shpallur vendimi i Gjykatës së Lartë por nuk ishte zbardhur ende, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të atij vendimi. Pas përcjelljes nga Prokuroria e Përgjithshme të akteve për procesin e ekstradimit të kërkuesit, ministri i Drejtësisë miratoi ekstradimin e kërkuesit nga Shqipëria në Federatën Ruse dhe dorëzimin e tij nga Interpol Tirana brenda datës 30.10.2024. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 30.10.2024, vendosi pezullimin e përkohshëm të procedurave të ekstradimit deri në një vendimarrje të dytë Gjykatës, por kërkuesi në po atë datë u dorëzua tek autoritetet ruse në aeroportin e Rinasit. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të cilat lejuan ekstradimin.

Vlerësimi i Gjykatës

Mbi legjitimitimin e kërkuesit – Megjithëse masa e kundërshtuar ka përfunduar, pasi kërkuesi është ekstraduar, kjo nuk përbën shkak për përjashtimin e saj nga kontrolli kushtetues, pasi, përndryshe, do të rrezikohej të zvogëlohej në mënyrë të paarsyeshme niveli i mbrojtjes së të drejtave themelore që ankimi kushtetues synon të garantojë, duke vënë në dyshim edhe efektivitetin e tij. Kërkuesi ruan interesin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi dhe mundet të pretendojë se është “viktimë” e shkeljes.

Për sa i takon pretendimet për të drejtën për azil, pavarësisht komunikimeve të kryera nga kërkuesi me autoritetet kompetente kërkesa për azil nuk u mor në shqyrtim lidhur me bazueshmërinë e saj, pasi nga autoritetet u konsiderua se nuk plotësonte aspektet formalë të saj. Megjithëse kërkuesi kishte mjete juridike në dispozicion, nuk i është drejtuar gjykatës për të kundërshtuar veprimet refuzuese të autoriteteve dhe për t'i detyruar ato të regjistronjë e shqyrtojnë kërkesën e tij për azil.

Për cenimin e së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit – Pretendimet e kërkuesit për gjendjen e tij shëndetësore nuk janë të tilla që të mund të vënë në diskutim respektimin e së drejtës së jetës në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së. Këto pretendime, për sa kohë që nuk është arritur të provohet pamundësia e trajtimit të këtyre problematikave në izolim, apo pamundësia e trajtimit të tyre nga autoritetet ruse gjatë kohës që kërkuesi është në izolim, nuk janë të tilla që të kalojnë barrën e provës të autoritetet lidhur me vlerësimin e pretendimeve për ekzistencën e rreziqeve dhe pasojave për jetën e kërkuesit.

Për sa u përket garancive të dhëna në kërkesën për ekstradim të autoriteteve ruse ato janë të përgjithshme, të dhëna nga një shtet joanëtar i Këshillit të Evropës dhe as palë e KEDNJ-së dhe në rastin konkret, vihet në diskutim besueshmëria e tyre. Në rastet kur rezultojnë në mënyrë të qartë se një personi të kërkuar për ekstradim në shtetin kërkues mund t'i mohohet haptazi e drejta për gjykim të drejtë, pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nuk mund të përjashtohet *a priori* nga vlerësimi i gjykatave të zakonshme.

(vijon në faqen 14)

Në kuptim të dimensionit ekstraterritorial të standardeve të gjykimit të drejtë në procedurat e ekstradimit, edhe pse shteti i kërkuar nuk është i detyruar të verifikojë në mënyrë të plotë respektimin e procesit të rregullt ligjor në shtetin kërkuar për procedurat që i kanë paraprirë ekstradimit, ai nuk mund të anashkalojë prova që tregojnë ekzistencën e një rreziku real se, në rast se lejohet ekstradimi, personi mund t'i nënshtrohet një mohimi flagrant të drejtësisë, rrethanë kjo që përbën shkak të mjaftueshëm për të penguar ekstradimin në shtetin kërkuar.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht nëse janë vendime të ndërmjetme, siç është edhe ai për pezullimin e ekstradimit, mbartin të njëjtën forcë detyruese për organet/palët të cilave u kundërdrejtohen.

Vendimet gjyqësore që lejuan ekstradimin nuk kanë përmbushur detyrimin për të sqaruar plotësisht rrethanat faktike që rezultojnë nga aktet e paraqitura nga kërkuar dhe as nuk kanë vlerësuar nëse ishte e nevojshme marrja e dokumentacionit kryesisht (*proprio motu*), sikundër nuk kanë kërkuar garanci shtesë lidhur me rrezikun e pretenduar për trajtimin e kërkuar në institucionet e paraburgimit në Federatën Ruse, duke u mjaftuar me sigurinë e dhënë në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për ekstradim. Autoritetet kompetente dhe gjykatat kanë qenë në dijeni dhe kanë pasur informacion të mjaftueshëm për problemet e trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe për të pasur mbrojtje efektive në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore e kushteve që ndalojnë ekstradimin sipas nenit 491, të KPP-së, në thelb nuk kanë garantuar të drejtën për të mos iu nënshtrohet trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe për të pasur mbrojtje efektive në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore.

Për mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese –Që nga koha e marrjes së vendimit për pezullimin e ekstradimit dhe komunikimit të tij dhe deri në largimin e kërkuar nga territori shqiptar, organet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim apo bërë përpjekje për marrjen e ndonjë mase me qëllim shtyrjen e ekstradimit në pritje të vendimit të Gjykatës, megjithëse nuk kanë pasur pengesë komunikimi. Ato nuk kanë informuar Gjykatën as për vijuesinë e situatës.

Dorëzimi i kërkuar tek autoritetet ruse nuk përbën, në vetvete, kalim të juridiksionit të shtetit shqiptar dhe as nuk i jep shtetit kërkuar të drejtën të ushtrimit të juridiksionit ekstraterritorial. Në kushtet që Gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të ekstradimit, vijimi i qëndrimit të kërkuar në shtetin shqiptar ishte i ligjshëm dhe ai gëzonte çdo të drejtë, garanci dhe mbrojtje kushtetuese, në kuptim edhe të nenit 39 të Kushtetutës.

Në mungesë të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë që lejon ekstradimin, individit vihet në pamundësi reale për të paraqitur ankim kushtetues dhe Gjykata në vështirësi objektive në vlerësimin *prima facie* të bazueshmërisë së kërkesës. “Momenti procedural vendimtar” për vënien në lëvizje të fazës administrative dhe llogaritjen e afatit të ankimit duhet të mbajë në konsideratë edhe komunikimin e vendimit gjyqësor të arsyetuar, çka bën të mundur ushtrimin real të së drejtës së ankimit kushtetues dhe zhvillimin e rregullt të fazës administrative të procesit të ekstradimit. Gjykatat e zakonshme duhet të sigurojnë, brenda një kohe sa më të shpejtë, përgatitjen dhe komunikimin e vendimeve të arsyetuara, ndërsa autoritetet përgjegjëse për fazën administrative duhet të organizojnë dhe të ndërmarrin veprimet procedurale në mënyrë që ushtrimi i ankimit kushtetues dhe kërkesa për pezullimin e ekstradimit të mos bëhen të pamundura në praktikë.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës, konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuar për të mos iu nënshtrohet trajtimit çnjerëzor dhe/ose degradues të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuar për të mos u dëbuar, të lidhur me detyrimin e autoriteteve publike për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Për pjesën tjetër të pretendimeve u vendos rrëzimi (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër dhe një gjyqtar me mendim pjesërisht kundër).



Caktim masash sigurimi personal - Aspektet procedurale dhe substanciale të lirisë personale

FJALË KYÇE

Moszbatim i urdhrat të ligjshëm/ Arrest në shtëpi/ Informacion dy-mujor/ kohëzgjatje/ Qëllimi dhe nevoja e vazhdimësisë së masës

Në lidhje me kohëzgjatjen e masës së sigurimit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së.

Sali Berisha

Zëvendësimi i masës së sigurimit personal në kuadër të informacionit dy-mujor të prokurorit Vendimi nr. 3, datë 15.01.2026

Faktet

Kërkuesi i është drejtuar edhe më parë Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kishin caktuar ndaj tij masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” (procesi i parë), dhe në vijim edhe të vendimeve gjyqësore që kanë zëvendësuar ato masa sigurimi me “Arresti në shtëpi” (procesi i dytë), për shkak se kërkuesi nuk kishte respektuar masën “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Ndërsa, Prokuroria e Posaçme, GJKKO e Shkallës së Parë, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë (procesi i tretë) kanë argumentuar se vijnë të ekzistojnë kushtet dhe kriteret e vlerësuara për vijimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke ligjruar vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit personal ndaj të hetuarve. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të procesit të tretë.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e lirisë personale - Gjykata vërejt se gjykatat në lejimin e vijimit, zgjatjes së masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme lidhur me kushtet dhe kriteret për të cilat është vendosur ajo, si dhe pse ato vijnë të jenë ende të nevojshme, duke mos justifikuar kështu konkretisht vazhdimin, zgjatjen e kufizimit të lirisë personale të tij. Gjykata, mbi bazën e të njëjtave argumente, me vendimin nr. 81/2024 të saj, konstatoi se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” duket se i plotësonte nevojat e sigurimit. Gjykata vërejt se në vendimet e gjykatave të zakonshme objekt kontrolli, ndonëse kishin kaluar 7 muaj nga caktimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, në lidhje me rrezikun e ikjes së kërkuesit nuk ka ndonjë arsytim, ndërsa për rrezikun e marrjes dhe të vërtetësisë së provave organi i prokurorisë, në vijim, por edhe gjykatat e zakonshme, në momentin fillestar të caktimit të masave të sigurimit, kanë vlerësuar se përmbushej nga masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Megjithatë, për të njëjtën nevojë sigurimi dhe pa evidentuar ndonjë rrethanë të re për ndonjë sjellje konkrete të kërkuesit në aspekt të kësaj nevojë sigurimi, në rastin në shqyrtim gjykatat e zakonshme kanë konsideruar se ajo përmbushej nga një masë sigurimi më e rëndë, ajo e “Arrestit në shtëpi”. Kufizimi i lirisë personale të kërkuesit me masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk mund të konsiderohet se arrin një ekuilibër të drejtë midis rëndësisë për sigurimin e zbatimit të një urdhri të ligjshëm të gjykatës dhe së drejtës për liri të tij. Periudha e qëndrimit të kërkuesit nën atë masë sigurimi nuk ka qenë në përputhje me qëllimin e vendosjes së urdhërimit të caktuar më parë nga gjykatat, i cili nuk është zbatuar prej tij. Gjykata evidentoi se individualizimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” në rastin e kërkuesit nuk i përgjigjej nevojës për sigurim me atë masë dhe gjykatat nuk kanë justifikuar kohëzgjatjen e saj, duke passjellë kështu edhe kufizimin e lirisë personale të kërkuesit në mënyrë joproporcionale me nevojat e hetimit. Gjykata vlerësoi se, vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues, që kanë disponuar për vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata arriti në përfundimin se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë nuk kanë qenë të mjaftueshme në drejtim të qëllimit dhe nevojës, që të justifikonin vazhdimin, zgjatjen e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit “Arresti në shtëpi”, ndaj pretendimi i tij për cenimin e lirisë personale, është i bazuar. Gjithsesi, duke qenë se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk është më në fuqi, pasi GJKKO-ja e Apelit në datën 03.01.2025 ka vendosur zëvendësimin e saj me masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, Gjykata çmoi të mos i shfuqizojë vendimet objekt të këtij shqyrtimi kushtetues.

Vendimarrja

Gjykata, me shumicë votash, vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim paralel dhe një gjyqtar u shpreh me mendim pjesërisht kundër).



Aspektet procedurale dhe substanciale të lirisë personale – revokim dhe zëvendësim mase sigurimi

FJALË KYÇE

Arrest në shtëpi/procedim penal/ kufizim i lirisë personale/ informacioni dy-mujor i prokurorisë/ dyshim i arsyeshëm/ revokim e zëvendësim mase sigurimi / neni 246 i KPP-së

Informacioni dy-mujor i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme nuk është trajtuar në mënyrë formale ose mekanike nga gjykatat, por është analizuar si element i ri në funksion të këtij kontrolli periodik. Gjykatat e zakonshme nuk janë mjaftuar me një ripërsëritje automatike të arsyeve që kanë justifikuar vendosjen fillestare të masës së sigurimit, por kanë ushtruar një kontroll të përditësuar për domosdoshmërinë e vijimit të saj.

Jamarbër Malltezi

Zëvendësimi i masës së sigurimit personal në kuadër të informacionit dy-mujor të prokurorit

Vendimi nr. 4, datë 15.01.2026

Faktet

Në kuadër të një procedimi penal ndaj kërkuesit është vendosur masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, e cila është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë. Procesi gjyqësor për caktimin e masës është bërë objekt gjykimi në Gjykatë, e cila rrëzoi kërkesën e kërkuesit. Në vijim, bazuar në nenin 246, pika 6 të KPP-së Prokuroria e Posaçme ka paraqitur informacionin dy-mujor duke u shprehur se masa e sigurimit duhet të vazhdojë. Në të njëjtën kohë, kërkuesi ka kërkuar revokimin e masës. Në përfundim, gjykatat kanë vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal. Edhe ky proces gjyqësor është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatë, i cili ka pretenduar sërish cenimin e lirisë personale në aspektin procedural dhe substancial.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimitimin e kërkuesit - Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike Gjykata vlerësoi se pavarësisht faktit se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë natyrë periodike, pasi dalin bazuar në detyrimin e prokurorit për të informuar çdo dy muaj gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, ato konsiderohen përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues.

Për cenimin e lirisë personale - Gjykata vlerësoi fillimisht se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm se edhe në vijim ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Në këtë drejtim, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë konkrete nevojën për vijimin e masës së sigurimit, si dhe kriterin e rrezikut të largimit, me qëllim shmangien e procedimit penal dhe rrezikun e marrjes dhe manipulimit të provave.

Gjykatat kanë arsyetuar se veprimet hetimore të pasqyruara në informacionin periodik jo vetëm që nuk e zbehin dyshimin e arsyeshëm, por e konsolidojnë atë. Po kështu, mungesa e përfundimit të hetimeve dhe natyra e provave të mbledhura janë vlerësuar si elemente që në këtë fazë procedurale e bëjnë ende të nevojshëm vijimin e masës së sigurimit, në përputhje me kriteret ligjore dhe me kërkesën për një arsyetim të vazhdueshëm dhe proporcional të kufizimit të lirisë personale. Duke pasur parasysh edhe objektin e procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, që lidhet me informacionin dymujor në kuadër të procedimit penal të nisur ndaj tij, Gjykata vlerësoi se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë janë të mjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese për të justifikuar vazhdimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit “Arresti në shtëpi”, ndaj vendimet e tyre përmbushin standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim pakice).



E drejta për gjykim të drejtë

FJALË KYÇE

Aksident automobilistik me pasojë vdekjen /kompani sigurimesh/ dëmshpërblim/ dëm pasuror/ dëm moral dhe ekzistencial/ kamatëvonesa/ dekreti nr.295/1992/ vendimi unifikues nr. 12/2007

Pjesa arsyetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë ka respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, duke garantuar në këtë mënyrë edhe thelbin e së drejtës së jetës, të parashikuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në kuptim të garantimit të së drejtës për dëmshpërblim të përshtatshëm për familjarët e viktimës.

E drejta për të kërkuar kamatëvonesat është në vetvete një e drejtë me natyrë ligjore e nuk është e kushtëzuar me momentin kohor të ngritjes së padisë, dhe vetë i padituri ose përmbartuesi gjyqësor në momentin e ekzekutimit duhet të llogarisë kamatëvonesat në bazë të përqindjes së normës bazë të interesit të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Zoica Lina, Ilirjan Lina

Shpërblim dëmi për humbjen e jetës së familjarit

Vendim nr. 5, datë 26.01.2026

Faktet

Gjatë një aksidenti automobilistik ka humbur jetën fillimisht shtetasi K.L., dhe një muaj më vonë si pasojë e plagëve të marra edhe djali i tij. Automjeti, që kishte shkaktuar aksidentin, ishte i siguruar pranë shoqërisë së sigurimit me afat në 21.04.2007. Duke qenë se aksidenti ka ndodhur në datën 09.04.2007, dëmi i ardhur si pasojë e tij do të mbulohej nga polica e sigurimit.

Për kërkimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar, si pasojë e aksidentit, kërkuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve, respektivisht bashkëshortja/nëna dhe djali/vëllai i janë drejtuar gjykatës së shkallës së parë duke paditur shoqërinë e sigurimeve me kërkesëpadi për pagimin e dëmit pasuror e jopasuror, shpenzimeve të tjera të arsyeshme e të nevojshme, si dhe kamatëvonesave nga subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit të automjetit me të cilin ndodhi aksidenti.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadinë, duke rrëzuar kërkesën për kamatëvonesat. Pas kthimit për rigjykim nga gjykata e apelit për shkak të shkeljeve procedurale, gjykata e shkallës së parë ka vendosur përsëri pranimin pjesërisht të kërkesëpadiisë. Gjykata e Apelit vendosi ndryshimin e vendimit të shkallës së parë duke rillogaritur vlerën e dëmshpërblimit për dëmin pasuror dhe jopasuror në favor të kërkuesve, si dhe rrëzimin e padisë për kamatëvonesat. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit për ligjin e zbatueshëm dhe përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit, por të pabazuar në ligj qëndrimin e gjykatave më të ulëta për pagesën e kamatëvonesave, duke arsyetuar se llogaritja e kamatëvonesave në rastin konkret do të fillonte nga momenti i kërkimit të tyre, deri në momentin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë - Gjykata vlerësoi se thelbi i pretendimit lidhej me kërkimin e shpërblimit të dëmit, si pasojë e humbjes së jetës dhe për këtë arsye analizoi çështjen në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë. Gjykata konstatoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në respektim edhe të parimit të subsidiaritetit, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit lidhur me metodologjinë e përcaktimit të shpërblimit të dëmit pasuror dhe jopasuror, duke iu referuar dekretit nr. 295/1992, rregullores të dalë për zbatimin e tij për përcaktimin e dëmit pasuror, si dhe vendimit unifikues nr. 12/2007 për rregullimin e dëmit jopasuror.

Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesit për ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e rastit konkret, për riçeljen e hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit. Kërkuesit kanë realizuar të drejtën e tyre për kërkimin e shumave të shpërblimit edhe të kamatëvonesave (ndryshe nga qëndrimet e dy gjykatave më të ulëta), për shkak të humbjes së jetës së familjarëve të tyre. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur edhe kriteret që duhen mbajtur parasysh në llogaritjen e interesave, sipas normës së interesit bazë të depozitës (sipas llojit të saj), bazuar në përcaktimet e Bankës së Shqipërisë.

Gjykata çmoi se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë është i pabazuar.



Kriteret e legjitimitit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual

FJALË KYÇE

Ratione personae/ Personi juridik që ushtron pushtet publik/ Akte administrative/ Evokim i të drejtave dhe garancive kushtetuese/ Të drejta substanciale dhe procedurale

Një person juridik nuk është automatikisht bartës i një të drejte themelore ose garancie kushtetuese, por ka vend t'i nënshtrohet një testi me dy hapa:

(i) duhet të vlerësohet nëse e drejta themelore ose garancia kushtetuese e pretenduar përputhet me qëllimin për të cilin personi juridik ekziston dhe vepron, pra nëse evokimi i asaj të drejte është në përputhje me statusin, funksionin dhe veprimtarinë e tij në raportin juridik konkret; dhe

(ii) duhet të vlerësohet nëse natyra dhe thelbi i asaj të drejte ose garancie lejojnë shtrirjen e saj te personi juridik, pa cenuar funksionin kushtetues dhe qëllimin mbrojtës të saj. Vetëm nëse këto dy kushte plotësohen në mënyrë kumulative, e drejta themelore ose garancia kushtetuese mund të konsiderohet e zbatueshme për personin juridik në fjalë.

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural

Legjitimimi ratione personae i personit juridik që ushtron pushtet publik – locus standi

Vendimi nr. 6, datë 28.01.2026

Faktet

Kërkuesja, në cilësinë e punëdhënësit, ka kryer veprime përmes akteve administrative për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me një individ në cilësinë e punëmarrësit, të cilat janë bërë objekt kundërshtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Këto të fundit kanë kontrolluar ligjshmërinë e veprimtarisë së kërkueses dhe kanë konkluduar se veprimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nuk kanë qenë në përputhje me ligjin, ndaj aktet e nxjerra për këtë qëllim janë të paligjshme. Kontrolli kushtetues për procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme është bërë objekt kërkimi nga kërkuesja nëpërmjet mjetit të ankimit kushtetues individual, me pretendimin se gjykatat kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në disa drejtime, sipas garancive të nenit 42 të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimimin e kërkueses në lidhje me kriterin ratione personae - Gjykata evidentoi se kërkuesja është një ministri, pra person juridik publik, e cila, në marrëdhënien e shërbimit civil objekt shqyrtimi, ka vepruar si autoritet administrativ dhe si punëdhënës publik. Qëllimi i saj i përgjithshëm lidhet me ushtrimin e funksioneve publike dhe zbatimin e ligjit në interes publik. Garancitë procedurale, në thelbin e tyre, synojnë mbrojtjen e subjektit të cenuar nga ushtrimi i autoritetit publik dhe parandalimin e arbitraritetit në vendimmarrje. Për rrjedhojë, ato janë konceptuar kryesisht për subjektet ndaj të cilëve ushtrohet pushteti publik, dhe jo për vetë organet publike, të cilat, në rendin kushtetues, bartin detyrimin për t'i respektuar dhe garantuar ato.

Gjykata theksoi se vlerësimi i mësipërm nuk nënkupton mohimin, në plan abstrakt, të natyrës kushtetuese të garancive procedurale të nenit 42 të Kushtetutës, por lidhet me mungesën e legjitimitit të kërkueses, si person juridik publik në rrethanat konkrete të çështjes, për t'i evokuar këto garanci si titullare. Gjykata vlerësoi se kërkuesja nuk plotëson kriterin ratione personae, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ndaj dhe nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim paralel)



Caktim mase sigurimi personal - Aspektet procedurale dhe substanciale të lirisë personale – Dyshimi i arsyeshëm - Parimi i proporcionalitetit

FJALË KYÇE

Procedim penal/ neni 230 i KPP-së/ sine qua non/ kufizim i lirisë personale/ dyshim i arsyeshëm/ zëvendësim i masës së sigurimit/ arrest me burg/ garanci pasurore / proporcionaliteti i masës

Qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”.

Kërkesa “dyshime të arsyeshme” për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal.

Ilir Beqaj

Kufizimi i lirisë personale

Vendimi nr. 7, datë 28.01.2026

Faktet

Kërkuesi nga viti 2021 ka qenë i ngarkuar me detyrën e drejtorit të SASPAC-ut, duke vepruar si Koordinator Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian lidhur me ndihmën e huaj për programe dhe projekte zhvillimore. Ai dyshohet se, në kundërshtim me ligjin, nuk ka deklaruar pasuri, të cilat, nga hetimet, rezultojnë në pronësinë e tij, si dhe dyshohet që në cilësinë e drejtorit të SASPAC-ut ka realizuar përfitime të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar emrat e autorëve të dyshuar, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkuesit, ndërsa ky i fundit është i dyshuar si autor i veprave penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim me pasoja të rënda, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankande publike”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”. Mbi keto dyshime të tre gjykatat kanë caktuar masën e arrestit në burg. Kërkuesi ka pretenduar në thelb se masa e sigurimit të arrestit në burg nuk është proporcionale dhe se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, me anë të të cilit i kanë cenuar atij lirinë personale. Pretendimet e tij u prapësuan nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e lirisë personale - në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova - Gjykata vërejt se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Gjykata, gjithashtu vërejt se, nuk rezultoi që gjykatat e zakonshme të kenë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ato të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar në rastin konkret pozitën e kërkuesit. Ndërkohë, Gjykata e Apelit nuk ka zgjeruar faktin penal të paraqitur nga prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, është e qartë që vlerësimi i saj për ekzistencën e elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve për faktin e paraqitur nga prokurori nuk përbën ngritje të një akuze të re nga gjykata. Gjykata vërejt se nuk rezultoi që gjykatat e zakonshme të kenë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ato të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar në rastin konkret pozitën e kërkuesit. Gjithashtu, vendimet e cituara, të ngjashme në dukje, nuk janë vendime unifikuese ose njësuere të detyrueshme për zbatim, ndaj ato janë të pamjaftueshme për të krijuar pritshmëri të ligjshme nga ana e kërkuesit. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe ai në drejtim të sigurisë juridike janë të pabazuara.

Në lidhje me parimin e proporcionalitetit të masës së sigurimit - Gjykata vërejt se në vendimet e tyre gjykatat kanë dhënë arsye të tjera të veçanta, të tilla si rreziku i marrjes dhe manipulimit të provave, rreziku i largimit, rreziku i arratisjes së kërkuesit, si dhe, megjithëse në masë të vogël, rreziku që kërkuesi të kryente vepra të tjera penale, arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e vazhdimin të paraburgimit të një individi. Gjykata vlerësoi se garancia pasurore sipas nenit 28, pika 3, të Kushtetutës lidhet me kohëzgjatjen e masës, në rast të kontrollit vijues të vendimeve për caktimin e saj. Ndërkohë që, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit kushtetues, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit, parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion, i referohet momentit faktik kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues. Thënë ndryshe, kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kërkon që masa e heqjes së lirisë të ketë humbur qëllimin e saj, pra të mos justifikohet më me arsye të interesit publik.

ANKIM KUSHTETUES INDIVIDUAL

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konfirmuar se përmbushet edhe përshtatshmëria, si dhe proporcionaliteti i masës në raport me rrethanat e faktit, rolin dhe pozitën e personit nën hetim, si dhe në raport me nevojat e sigurimit. Gjykatat e zakonshme kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë në këtë rast të atyre rreziqeve, duke evidentuar kompleksitetin e hetimit, në pikëpamje të shtrirjes në kohë të veprimtarisë së dyshuar si kriminale, bashkëpunimin, rolin e tij në kryerjen e veprave penale, por edhe ndikimin potencial negativ që ai mund të kishte në vijimin e hetimeve.

Në këtë mënyrë, Gjykata çmoi se paraqitja e kërkesës për t'u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore kërkon kalimin e një periudhe kohe, pas së cilës gjykata mund të verifikojë nëse ekzistojnë ende kushtet dhe nevojat e sigurimit.

Gjykata vlerësoi se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg", janë të pabazuara, për sa kohë që masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, dhe ajo nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me veprat penale për të cilat ai dyshohet, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj.

Vendimmarrja

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).



Legjitimimi i kërkuesit sa i takon shterimit të mjeteve efektive - Parimi i sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar

FJALË KYÇE

Avokat i Përgjithshëm i Shtetit/masë disiplinore/ vërejtje me paralajmërim/ shkarkim nga detyra/afat ankimimi/rigjykim i çështjes/vendim jopërfundimtar/ shterim/subsidiaritet.

Vendimet gjyqësore për kthimin e çështjes për rigjykim i nënshtrohen kontrollit kushtetues në raste përjashtimore, që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar, të lidhur domosdoshmërisht me faktin që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë mbajtur qëndrim të shprehur përfundimtar për çështjen e faktit dhe/ose të ligjit, që ka diktuar ecurinë e çështjes.

Endri Kotherja

Moslegjitimim për mosshkrim të mjeteve efektive

Vendimi nr. 9, datë 11.02.2026

Faktet

Kërkuesi ishte avokat i shtetit dhe pas tre vërejtjesh me paralajmërim, është shkarkuar nga detyra. Padia e tij për pavlefshmërinë e urdhrin të shkarkimit dhe të të tria masave të tjera disiplinore, si dhe rikthimin në detyrë u pranua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Vendimi u ankimua nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, por gjykata e shkallës së parë vendosi mospranimin e tij për shkak të të metave. Vendimi u ndryshua nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Kërkuesi u ankuar në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar se apeli ishte paraqitur nga Avokatura e Shtetit jashtë afatit. Ankimi i tij nuk u mor në shqyrtim, me arsyetimin se nuk plotësohej kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive.

Ndërkohë, çështja e themelit u shqyrtua në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, la në fuqi vendimin për pranimin e padisë. Gjykata e Lartë, vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe ktheu çështjen për rigjykim në shkallë të dytë, për verifikimin e respektimit të afatit ligjor të ngritjes së padisë.

Kërkuesi iu drejtua përsëri Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur sërish çështjen e afatit të apelit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimitimin e kërkuesit në lidhje me shterimin e mjeteve juridike efektive - Gjykata vërejtë se gjykata e apelit, në rigjykim, krahas detyrimit ligjor për të zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë, duhet të luajë rolin e saj kushtetues subsidiar për respektimin e të drejtave themelore, duke i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit për afatin e paraqitjes së apelit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Ana tjetër e parimit të subsidiaritetit lidhet me nevojën për të identifikuar dhe riparuar sa më shpejt shkeljen e të drejtave themelore, pra sapo ato bëhen të ditura për gjykatat e zakonshme. Këto të fundit, duke pasur kompetencën për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve ligjore të qytetarëve, janë në pozicionin e duhur për të filluar dhe, nëse është e nevojshme, për t'i dhënë forcë detyruese interpretimit kushtetues që mbron të drejtat themelore.

Gjykata arriti në përfundimin se shkeljet e pretenduara mund dhe duhet të marrin përgjigje gjatë rigjyimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, ndaj vendimi i Gjykatës së Lartë i kundërshtuar në ankimin kushtetues individual nuk ishte përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.



E drejta për proces të rregullt ligjor - E drejta e aksesit e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur dhe të drejtën për t'u dëgjuar – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar

FJALË KYÇE

Gjykata e Paqit/dokument i falsifikuar/gjë e gjykuar-res judicata/njoftim për gjykimin/adresë elektronike/dhomë këshillimi

Gjykata, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, evidentoi se mospranimi i rekursit vendoset në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga kjo dispozitë. Po kështu, sipas Gjykatës edhe pse kërkuesit kanë barrën e provës në këtë drejtim, nuk kanë arritur të provojnë në aspektin kushtetues cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit.

Kadri Pazari dhe Engjëll Kazazi

Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar”

Vendimi nr. 10, datë 11.02.2026

Faktet

Objekti i konfliktit gjyqësor të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) lidhet me një mosmarrëveshje pronësie për një truall, pronësia e të cilit është njohur me vendim të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme, kërkuesit (palë e paditur), për të mbështetur pretendimet e tyre në lidhje me pronësinë e truallit, kanë paraqitur si provë një vendim të Gjykatës së Paqit të vitit 1939. Në përfundim të gjykimit në të gjitha shkallët, është vendosur rrëzimi i kërkesëpadiisë. Ky proces gjyqësor është bërë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata, e cila në vitin 2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Lidhur me vendimin e Gjykatës së Paqit të vitit 1939, organi i akuzës edhe pse kishte filluar dy procedime penale për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, në përfundim të hetimeve vendosi pushimin e çështjes penale dhe mosfillimin e procedimit penal. Kjo vendimmarrje e organit të akuzës u vlerësua e drejtë nga gjykatat e të tria shkallëve. Në vijim, nga palët është nisur një proces gjyqësor, në përfundim të të cilit është vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Paqit i vitit 1939, është i falsifikuar. Ky proces gjyqësor u bë më pas objekt shqyrtimi nga Gjykata.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e dëgjuar – Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuesit, të përfaqësuar nga avokati i zgjedhur prej tyre, të cilët kanë pasur mundësinë të parashitrojnë të gjitha pretendimet e tyre në të, si dhe faktin se subjektet e interesuara, palë paditëse në procesin kryesor, nuk kanë paraqitur kundërrekurs, por vetëm kërkesa për përshpejtimin e gjykimit. Në këto kushte, në vlerësimin e Gjykatës, nuk provohet që ata të jenë vendosur në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar në aspektin substancial. Po ashtu, Gjykata çmoi se Gjykata e Lartë i kishte njoftuar kërkuesit edhe individualisht, nëpërmjet adresës elektronike të avokatit të tyre, duke garantuar për palët dhe, në veçanti për kërkuesit, të drejtën për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe njoftimin e rregullt si element të këtij procesi.

Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” – Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

Sipas njërit qëndrim, gjykatat në vendimet e kundërshtuara kanë bërë një analizë të plotë të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, duke analizuar në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar, duke arritur më pas në përfundimin se pretendimi për cenimin e sigurisë juridike të lidhur me gjënë e gjykuar nuk qëndron. Nga ana tjetër, sipas këtij qëndrimi, argumentet e kërkuesve, në thelb, kanë të bëjnë me vendimin nr. 38/2016 të Gjykatës së Lartë, me anë të të cilit çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit, vendim i cili nuk rezultoi të jetë kundërshtuar më parë nga kërkuesit.

Sipas qëndrimit tjetër, çështja e vërtetësisë së vendimit të Gjykatës së Paqit mori cilësinë e gjësë së gjykuar, ndaj në respektim të parimit të sigurisë juridike, asnjë gjykatë nuk mund ta gjykonte sërish atë, pa ndjekur procedurat ligjore për riparimin e gabimeve të rënda në administrimin e drejtësisë, siç është procedura e rishikimit. Megjithatë, Gjykata e Lartë, me vendimin vitit 2016, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, e ka rihapur sërish çështjen e falsitetit, duke ia nënshtuar përsëri debatit dhe vlerësimit gjyqësor, pa u ndalur në vlerën e gjësë së gjykuar që ajo çështje kishte marrë. Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, duke lënë si detyrë se duhej verifikuar sërish pretendimi për falsifikimin e atij vendimi. Në zbatim të këtij vendimi, gjykata e apelit dhe, më pas, Gjykata e Lartë kanë dhënë vendimet e kundërshtuara, të cilat po ashtu janë në shkelje të parimit të sigurisë juridike.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh (një gjyqtar u shpreh me mendim paralel).



E drejta e aksesit në gjykatë - standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Urdhër i lirimit nga detyra / nëpunës civil /pavlefshmëri absolute e aktit administrativ/ neni 155 i Kodit të Punës/ qasje formaliste/ e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme/ iuria novit curia

Në rastin kur individi kundërshton paligjshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, gjykatat e zakonshme nuk mund të kufizohen vetëm në konstatimin nëse zgjidhja është e rregullt ose jo, por ato kanë detyrimin të shprehën edhe për pasojat e paligjshmërisë.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të tregohen formaliste, duke lënë pa përgjigje pretendime thelbësore nisur thjesht dhe vetëm nga fakti se paditësit nuk kanë identifikuar saktë bazën ligjore ku mbështesin pretendimet e tyre, pasi është detyrë e gjykatës të kualifikojë vetë mosmarrëveshjen në përputhje me parimin iuria novit curia.

Gjykatat e zakonshme nuk janë të lidhura nga kualifikimi juridik që palët i bëjnë mosmarrëveshjes, pasi mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë, ndaj dhe është detyrë e gjykatës që të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë.

Valentina Kodheli

Largim i paligjshëm nga puna

Vendimi nr. 11, datë 11.02.2026

Faktet

Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për shfuqizimin e urdhrin të lirimit të saj nga detyra, rikthimin në punë dhe pagimin e pagës, në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (ligji për nëpunësin civil). Gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesëpadinë duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, detyrimin e palës së paditur për të kthyer kërkuesen në pozicionin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës nga data e lirimit e në vazhdim. Ky vendim është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka çmuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete zbatohet Kodi i Punës dhe jo ligji për nëpunësin civil, me arsyetimin se statusi i nëpunësit civil nuk fitohet automatikisht për shkak të ligjit. Në vijim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar nga ish-punëdhënësi, për pasojë i ka caktuar kërkueses masën e dëmshpërblimit sipas neni 155 të Kodit të Punës. Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë në tërësinë e saj, me arsyetimin se, ndonëse gjykata e apelit e ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm, ajo e ka zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar në një shkak tjetër ligjor, të papretenduar dhe të pakërkuar nga ana e kërkueses.

Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata fillimisht konstatoi se pavarësisht se urdhri i lirimit nuk ishte i bazuar në Kodin e Punës, por në dispozitat e ligjit për statusin e nëpunësit civil, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk e kanë analizuar këtë rrethanë. Edhe pse kërkuesja ka pretenduar paligjshmërinë e lirimit nga detyra/ndërprerjes së marrëdhënies së shërbimit civil dhe zgjidhjen e pasojave të kësaj paligjshmërie, gjykata e apelit e ka pranuar paligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies të punës, duke mos e konsideruar atë si marrëdhënie shërbimi civil, por sipas Kodit të Punës. Gjykata e Lartë ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së apelit lidhur me ligjin e zbatueshëm, por duke mos shqyrtuar në themel nëse lirimi nga detyra ka qenë apo jo në përputhje me ligjin, qoftë edhe me ligjin e identifikuar prej saj si ligji i zbatueshëm, me arsyetimin se nuk ka kërkitime në padi për zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë së lirimit nga detyra referuar Kodit të Punës.

Gjykata vlerësoi se në thelb të padisë së kërkueses, pavarësisht bazës ligjore të përdorur, ka qenë ndërprerja pa shkak të ligjshëm e marrëdhënies së shërbimit civil (lloji i marrëdhënies të punës) dhe rregullimi i pasojave që rrjedhin prej saj. Në këtë kuptim, Gjykata çmoi se pretendimi thelbësor për paligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të zgjidhjes së pasojave të tij, nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë qoftë edhe sipas ligjit të identifikuar si të zbatueshëm prej saj. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim formalist, duke mos shkuar përtej ligjit për të synuar të drejtën. Për rrjedhojë, sipas saj, kërkueses i është cenuar edhe e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjeshëm të kërkesës



Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Ish ushtarak/ ulje në gradë/ dekret i Presidentit/ urdhër i Ministrit/ të drejta financiare/ oficer aktiv/ oficer rezervë/ legjislacion i posaçëm për gradat dhe statusin e ushtarakut/ vendim gjykate/ fuqi detyruese/ratio decidendi/ detyrim kushtetues /forcë e ligjit /luajalitet kushtetues

Për sa kohë Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkesit, Gjykata, pa u vendosur në rolin e një shkalle të katërt gjykimi për të rivlerësuar mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga ajo gjykatë, vlerësoi se vendimi nuk paraqet mangësi në arsyetim që të vënë në dyshim pajtueshmërinë me standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, debati mbi kufijtë e juridiksioneve është i lejueshëm për sa kohë zhvillohet në nivelin e argumenteve teknike, por ai duhet të zhvillohet me gjuhë të matur dhe në frymën e korrektesës së ndërsjellë institucionale, duke respektuar kompetencat kushtetuese të secilit organ dhe në atë mënyrë që të mos bëhet shkas për luhatje të besimit publik, aq i rëndësishëm në shtetin e së drejtës.

Gjergj Vladi

Kthimi për rigjykim i çështjes nga Gjykata Kushtetuese

Vendimi nr. 12, datë 12.02.2026

Faktet

Kërkuesi “oficer aktiv” i Forcave të Armatosura me gradë “Gjeneral brigade” u lirua nga detyra në vitin 1997 me dekret të Presidentit dhe më pas, u ul në gradë për shkelje të rëndë të disiplinës ushtarake. Në vitin 1998, kërkuesi është nxjerrë në rezervë me urdhër të ministrit të Mbrojtjes dhe i janë ndërprerë të drejtat financiare si oficer aktiv.

Kërkuesi iu drejtua gjykatës me kërkesëpadi për anulimin e dekretit për uljen në gradë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e vitit 2006, vendosi anulimin pjesërisht të dekretit të Presidentit dhe urdhëroi ekzekutimin e vendimit. Në vitin 2007, kërkuesi u nxor sërish në rezervë, duke u trajtuar me pagesë kalimtare.

Kërkuesi iu drejtua gjykatës me padi me objekt detyrimin e Ministrisë së Mbrojtjes, t’i paguante shpërblimin e pagës, shpërblimin për vjetërsi, shpërblimin për shkak të gradës, si dhe shpërblimin e pagës së bashkëshortes për periudhën e heqjes së gradës në vitet 1998-2007. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë. Vendimi u ndryshua pjesërisht nga Gjykata e Apelit Tiranë, por Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.


Në vitin 2016 kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë kishte cenuar parimin e sigurisë juridike dhe standardin e arsyetimit të vendimit (kërkesa nr. 1). Gjykata vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgoi çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vendosi sërish prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në 2023 kërkuesi iu drejtua përsëri Gjykatës, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës (kërkesa nr. 2). Gjykata, pasi e vlerësoi të bazuar pretendimin e kërkesit për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të saj, shfuqizoi vendimin dhe dërgoi çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë rishqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me qëllim zhvillimin e praktikës gjyqësore lidhur me të drejtat që rrjedhin nga mbajtja e statusit të ushtarakut aktiv dhe atij në rezervë. Në përfundim, Gjykata e Lartë vendosi sërish prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkuesi iu drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata çmoi se në vendimet e saj të mëparshme, kur ka evidentuar nevojën për ndërhyrjen e Gjykatës së Lartë në funksion të njëtrajshmërisë dhe koherencës së praktikës gjyqësore, ajo nuk ka pasur si qëllim thjesht nxjerrjen e një vendimi njësoj në kuptimin formal, por garantimin e standardit të sigurisë juridike përmes një qasjeje të njëtrajtshme dhe të arsyetuar për çështjen juridike të ngritur, në mënyrë që të shmangeshin qëndrimet e kundërta në jurisprudencë dhe të sigurohej parashikueshmëria e zbatimit të ligjit. Gjykata vërejtë se Gjykata e Lartë e ka përmbytur këtë detyrë, së pari, në aspektin procedural, duke ia kaluar çështjen për shqyrtim trupës me pesë gjyqtarë, si organi që ushtron funksionin e njësitimit ose të zhvillimit të praktikës gjyqësore, dhe, së dyti, në aspektin substancial, duke mbajtur qëndrim të shprehur për çështjet thelbësore të ngritura në gjykim, në ushtrim të kompetencës sipas nenit 141 të Kushtetutës.

ANKIM KUSHTETUES INDIVIDUAL



Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit për mungesën e tagrave të përfaqësimit të palës së paditur rekursuese, Ministrisë së Mbrojtjes, duke arsyetuar se kjo e fundit ishte përfaqësuar në gjykim nga një person i autorizuar dhe se, nëse do pranohej ekzistenca e një parregullsie fillestare në ushtrimin e rekursit, ajo ishte konvaliduar nga miratimi i mëvonshëm i palës së paditur në seancë gjyqësore.

Në përmbushje të detyrës së lënë nga Gjykata për arsyetimin e efekteve të vendimit gjyqësor të formës së prerë me të cilin ishte anuluar dekreti për uljen në gradë të kërkuarit, Gjykata e Lartë ka argumentuar se anulimi i atij dekreti nuk ka sjellë si pasojë edhe shfuqizimin e urdhit të ministrit të Mbrojtjes për daljen e kërkuarit në rezervë, pra nuk ka sjellë kthimin e tij në statusin e ushtarakut aktiv. Gjithashtu, ajo ka arsyetuar se padia ishte parashkruar, duke iu referuar neneve 112 dhe 115, shkronja “dh”, të Kodit Civil dhe nenit 203 të Kodit të Punës.

Mënyra e veprimit të Gjykatës së Lartë ka përmbushur, jo vetëm formalisht, por edhe në substancë, qëllimin e detyrës së lënë nga kjo Gjykatë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës



Parimi i së drejtës së aksesit në aspekt të ankimit efektiv të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës - E drejta e pronës

FJALË KYÇE

Pasuri e paluajtshme/ kontratë noteriale/ AMTP/ ZVRPP/ regjistër kadastral/ regjistrim fillestar i pronës/ vendim unifikues nr. 1/2009/ /qarkullim civil

Ndonëse në rekurs, pretendimet e kërkuases për zbatimin e gabuar të ligjit nuk janë ngritur për regjistrimin e pronës në regjistrat kadastralë të kohës, të ndryshëm nga regjistrat e pasurive të paluajtshme, Gjykata e Lartë, duke iu përmbajtur shkaqeve të rekursit dhe duke marrë në konsideratë edhe parashtrimet me shkrim të kërkuases përpara shqyrtimit të tij, ka mbajtur qëndrimin se për qëllime të zbatimit të ligjit material civil, përcaktues është regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe jo regjistrimi në çdo lloj regjistri publik. Në këtë mënyrë ajo i ka dhënë përgjigje, në thelb, edhe këtij pretendimi të kërkuases.

Amalia Zerri

Cenimi i së drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor
Vendim nr. 13, datë 16.02.2026

Faktet

Kërkuësja A.Z, trashëgimtare ligjore e të ndjerit S.Z., pretendon pronësinë mbi dy parcela toke të blera prej tij me kontrata noteriale në vitin 1996. Në vitin 2005, S.Z. u pajis me certifikata pronësie dhe më pas i shiti pasuritë, por kontratat e shitjes u revokuan për shkak se pas hetimit të Prokurorisë për falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre, rezultoi se certifikatat e pronësisë ishin të rreme dhe të falsifikuara. Ndërkohë, përfaqësuesi i njërit prej shitësve të parcelave u deklarua fajtor për veprën penale të mashtrimit dhe parcelat ishin rishitur tek blerës të tjerë. Si pasojë e procedimit penal, ZVRPP-ja Tiranë vendosi kufizim për kryerjen e veprimeve mbi sipërfaqet e truallit në “pronësi” të S.Z. Më pas, me kërkesë të një blerësi tjetër, A.E, gjykatat në vitin 2010 e hoqën këtë kufizim dhe i njohën A.E.-së të drejtën e pronësisë.

Në vitin 2011, kërkuësja dhe trashëgimtarët e tjerë kërkuan njohjen e pronësisë së tyre, pavlefshmërinë absolute të kontratave të tjera të shitjes, kthimin e posedimit, regjistrimin e pasurisë në emrin e tyre dhe shpërblimin e dëmit. Gjykata e shkallës së parë vendosi pranimin pjesërisht të kërkesëpadsisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratave të tjera të shitjes dhe urdhëruar fshirjen nga regjistri i ZVRPP-së, Tiranë të regjistrimit të pronësisë në emër të A.E. si dhe regjistrimin në emër të kërkuases dhe trashëgimtarëve të tjerë të S.Z. Gjykata e Apelit Tiranë (2014), ndryshoi vendimin dhe rrëzoi kërkesëpadsinë e kërkuases. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vendosi prishjen e vendimit të apelit dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë, me argumentin se gjykata e apelit nuk ka vlerësuar drejt shkakun e konfliktit midis palëve ndërgjyqëse, si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit material, zbatimit të gabuar të vendimit unifikues nr. 1/2009 dhe mosvlerësimit në tërësi të rrethanave të çështjes.

Në vitin 2023, shtetasi A.E. iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës, së drejtës së mbrojtjes dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vendosi pranimin e kërkesës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim për cenim të së drejtës së mbrojtjes dhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit.

Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja (dhe paditësit e tjerë) dhe kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit në aspekt të ankimit efektiv të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës - Gjykata çmoi se në rigjykim, Gjykata e Lartë e ka trajtuar çështjen e ligjit për të cilën ishte urdhëruar rigjykimi dhe ka mbajtur një qëndrim të shprehur e të arsyetuar në lidhje me të, duke përmbushur kështu kërkesat që buronin nga vendimi i saj nr. 57/2023. Në këtë kuptim, Gjykata evidentoi se Gjykata e Lartë ka dhënë një përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar për qëndrimin e saj lidhur me vlerën juridike të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe duke vlerësuar konkretisht se përpara disponimit pasuria duhet t’i jetë nënshtruar regjistrimit fillestar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të administruara nga ZVRPP-ja (sot ASHK). Po kështu, Gjykata vërejti se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë për raportin ndërmjet neneve 83 dhe 195 të KC-së, si dhe vendimit unifikues nr. 1/2009, në rastin konkret, nuk rezultoi, nga këndvështrimi kushtetues, të jetë i paarsyetuar, arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, duke i dhënë kërkuases një përgjigje të qartë, të arsyetuar dhe të mjaftueshme në kuptimin kushtetues; pra pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në aspekt të ankimit efektiv të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës është i pabazuar. Në kushtet kur pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës së pronës është i ndërvarur nga ai për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe ky i fundit është i pabazuar, Gjykata çmoi se, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është, gjithashtu, i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice, kundër)



E drejta e pronës private – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Aktivitet tregtar/organe tatimore/ gjobë administrative/DRT/shlyerje detyrimi tatimor/barasvlefshmëri me pronën private/ proporcionalitet

Pretendimi me natyrë kushtetuese lidhet me raportin e drejtë që duhet të ekzistojë midis interesit publik për mbrojtjen e sistemit tatimor nga informaliteti përmes caktimit të gjobës dhe mbrojtjes të së drejtës themelore të pronës së individit. Kur individ i ngarkohet me barrë të tepruar, atëherë prishet ekuilibri që duhet të ekzistojë midis interesave që synon të mbrojë parimi i proporcionalitetit.

Të drejtat themelore duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jenë efektive pasi në të kundërt rezultati mund të mos pajtohet me qëllimin e Kushtetutës, që është mbrojtja e të drejtave që nuk janë teorike ose iluzore, por praktike dhe efektive. Vlerësimi i gjykatës së apelit ishte tepër i ngushtë dhe formal, për rrjedhojë arsytimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ishte i pamjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

Shoqëria “International Distribution for Albania” Sh.a.

Interpretimi i ligjit nga gjykatat në drejtim të proporcionalitetit të vlerës së gjobës

Vendim nr. 14, datë 17.02.2026

Faktet

Kërkuesja ushtron aktivitetin tregtar “Bar-kafe” dhe gjatë një kontrolli të organeve tatimore u konstatua se nuk kishte lëshuar faturë tatimore, ndaj u gjobit me vlerë të konsiderueshme. Vlera e gjobës u llogarit si shkelje administrative për çdo tavolinë të gjetur. Pas ankimit të pasuksesshëm administrativ, ajo iu drejtua gjykatës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, pranoi pjesërisht padinë, duke e ulur vlerën e gjobës, me arsytimin se organi tatimor kishte zbatuar gabim nenin 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore pasi bëhej fjalë për një shkelje administrative.

Gjykata Administrative e Apelit, e ndryshoi vendimin dhe la në fuqi vlerën e gjobës, duke rrëzuar padinë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkueses, e cila i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës - Gjykata konstatoi se gjykata e apelit kishte arritur në përfundimin se neni 122, pika 1, i Ligjit për Procedurat Tatimore zbatohet për çdo rast (tavolinë) të konstatuar pa faturë tatimore dhe jo vetëm një herë. Në vendimin e gjykatës së apelit mungonte tërësisht vlerësimi ligjor për proporcionalitetin e vlerës së gjobës, në dallim nga gjykata administrative e shkallës së parë që kishte dhënë arsye të detajuara për zgjidhjen që i ka dhënë çështjes. Megjithatë rekursi i kërkueses lidhet me shkeljen potenciale të së drejtës kushtetuese të pronës në drejtim të proporcionalitetit të vlerës së gjobës, Gjykata e Lartë vendosi me arsytim të kufizuar mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje të shprehur pretendimit vendimtar për zgjidhjen e çështjes, që për shkak të diferencës domethënëse të vlerës financiare (100-fish), kërkonte vëmendje të shtuar prej saj. Interpretimi diametralisht i kundërt nga gjykatat e faktit i nenit 122 të Ligjit për Procedurat Tatimore dhe mosdhënia e një përgjigjeje përfundimtare nga Gjykata e Lartë për mënyrën e zbatimit të ligjit, ka bërë që, në thelb, pretendimi kushtetues i kërkueses të mbetet i pazgjidhur.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.



**Parimi i paanshmërisë –
Parimi i prezumimit të
pafajësisë – Standardi i
arsyetimit të vendimit
gjyqësor – E drejta e aksesit**

FJALË KYÇE

Rihapje e procesit/ zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së/ shkaqe rekursi/ neni 423 i Kodit të Procedurës Penale/ parimi i subsidiaritetit/ burgim i përjetshëm/ provë e vetme/ përgjigje e arsyetuar

Gjykata ripohoi faktin se Gjykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ushtron rolin e saj si gjykatë ligji për të gjithë territorin e vendit dhe për shkak të kësaj karakteristike kushtetuese, në parim, nuk përjashtohet mundësia që i njëjti gjyqtar të japë disa vendime brenda të njëjtit proces gjyqësor, nëse çështjet ligjore që shqyrtohen janë të ndryshme.

Në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, duhet analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve.

Edhe pse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e ngritur në rekurs për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, në kontekstin e rrethanave të rastit në shqyrtim dhe pabazueshmërisë në thelb të këtij pretendimi, kjo mangësi nuk është e atillë që të çojë në përfundimin se arsyetimi i vendimit të kundërshtuar në këtë rast ka cenuar të drejtën e kërkuarit për proces të rregullt ligjor.

Arben Frroku

*Rihapja e procesit në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së
Vendimi nr. 16, datë 17.02.2026*

Faktet

Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur delarimin e pafajshëm tij. Mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ndryshoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuarit, vendosi mospranimin e tij, duke lënë kështu në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), e cila, për shkak se nuk arriti kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 72, pika 2, të ligjit organik të saj, e konsideroi kërkesën të rrëzuar. Kërkuesi iu drejtua GJEDNJ-së, e cila, ka gjetur shkelje të së drejtës për proces të rregullt në drejtim të standardit të arsyetimit, për shkak se kërkuesi nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual të paraqitur më parë në Gjykatë. Bazuar në këtë vendim të GJEDNJ-së, kërkuesi iu drejtua përsëri Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor penal të zhvilluar ndaj tij dhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për rihapjen e procesit gjyqësor – Në këtë rast, Gjykata pohoi se kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkak i rihapjes, dhe kërkuesi nuk mund të zgjerohë shkaqet e ankimit kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to. Në këtë kuptim, Gjykata vlerësoi të marrë në shqyrtim dhe t’i japë përgjigje të arsyetuar vetëm pretendimeve të ngritura në ankimin e mëparshëm kushtetues.

Për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe prezumimit të pafajësisë – Gjykata vlerësoi se nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm fakti se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vleftësimin e masës së arrestit për të njëjtën çështje dhe se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në të dyja vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, duke qenë se ato kanë trajtuar çështje të ndryshme juridike. Në rastin e vlerësimit të masës së sigurimit, Kolegji Penal ka shqyrtuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe kritereve të tjera që, sipas dispozitave procedurale, lejojnë caktimin e masave kufizuese të lirisë, kurse në rastin e dytë, atë të shqyrtimit rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që ka dënuar kërkuesin, çështja juridike e shtruar përpara gjyqtarëve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kishte të bënte me vlerësimin e shkaqeve që lejojnë kundërshtimin e vendimit të fajësisë së kërkuarit (themeli i çështjes). Sipas Gjykatës, në këtë rastin e kundërshtimit të vendimit të dënimit, Kolegji Penal ka shqyrtuar pretendimet e kërkuarit për vendimmarrjen e gjykatës së apelit që ka shqyrtuar në themel çështjen e fajësisë së tij, pra me mospranimin e rekursit ka konfirmuar formalisht fajësinë e kërkuarit.

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – Në këtë rast, Gjykata vlerësoi se gjykata e apelit e ka arsyetuar vendimin e saj duke u dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuarit të paraqitura në apelin kundërshtues, si dhe duke analizuar edhe shkaqet pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i drejtë dhe duhej ndryshuar. Po ashtu, në vlerësimin e Gjykatës, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e shprehur në dispozitivin e vendimit të saj duke bërë një shqyrtim dhe analizë në tërësi të provave, dhe pa marrë të mirëqena pretendimet ose konkluzionet e organit të akuzës, duke çmuar se vendimi i asaj gjykatye (gjykatës së apelit), nuk është i paarsyetuar, kontradiktor, alogjik ose konfuz. Për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerësoi se ndonëse me arsyetim të kufizuar, ky vendim nuk rezultoi të mos ketë respektuar kritereve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e kolegjit për natyrën e këtyre shkaqeve.

Vendimmarrja

Gjykata me shumicë votash, vendosi, pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit në Gjykatë, shfuqizimin e vendimit nr. 14, datë 24.04.2018 të saj, dhe rrëzimin e ankimit kushtetues individual (dy gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).



Parimi i sigurisë juridike – E drejta e pronës

FJALË KYÇE

*Rihapje e procesit kushtetues/
GJEDNJ/ KKKP/ vendime të formës
së prerë të KKKP-ve/ kompetenca e
AKKP-së për të shqyrtuar vendimet
e KKKP-ve / Avokatura e Shtetit/
Ligji për Kthimin dhe Kompensimin
e Pronës*

Rihapja e procesit kushtetues mund të kërkohet vetëm kur cenimi i konstatuar nga gjykata ndërkombëtare ka ardhur si rrjedhojë e vendimit të mëparshëm të kësaj Gjykate.

Ndonëse kërkesa për rihapjen e procesit është paraqitur përpara saj, Gjykata vëren se, në thelb, ajo lidhet me rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 494, paragrafi 2, shkronja “ë”, të KPC-së. Në këto rrethana, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje efektive të të drejtave themelore të kërkueseve dhe së drejtës së tyre për një mjet juridik efektiv për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja, Gjykata çmon se çështja objekt gjykimi duhet t’i dërgohet për shqyrtim gjykatës kompetente, pra Gjykatës së Lartë.

Hysnie Mahmuti, Melaize Ruli, Lale Meçi

Rihapja e procesit në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së Vendim nr. 17, datë 23.02.2026

Faktet

Kërkueset janë trashëgimtare të shtetasit H.G. (babai), i cili, me një vendim të vitit 2006 të Komisionit Vendor për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Gjirokastrë (KVKKP Gjirokastrë) është njohur pronar mbi një pasuri të llojit “kullotë” në Gjirokastrë. Kjo sipërfaqe i është kthyer fizikisht trashëgimtarëve të H.G.-së.

Në vitin 2009, pas ndryshimit të Ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar (ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës), mbi bazën e kërkesës së një subjekti të interesuar, Avokatura e Shtetit ka paraqitur ankim për vendimin e mësipërm të KVKKP-së Gjirokastrë përpara drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP). Ky i fundit, me vendimin nr. 186, datë 25.05.2010 e ka konstatuar vendimin e KVKKP-së Gjirokastrë absolutisht të pavlefshëm.

Ndërkohë, kjo Gjykata ka vendosur shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, të ndryshuar, duke arsyetuar se pushteti i AKKP-së për të shqyrtuar vendimet e ish-komisioneve të pronave, edhe me nismën e saj, ishte antikushtetues, pasi kjo kompetencë i përkiste vetëm autoritetit gjyqësor. Edhe ndryshimet e tjera ligjore të vitit 2010, Gjykata i shpalli sërish antikushtetuese, si dispozita që cenonin parimin e sigurisë juridike dhe të drejtës së pronës.

I ati i kërkueseve kërkoi anulimin e vendimit të drejtorit të AKKP-së (2010), por gjykata e shkallës së parë e rrëzoi padinë. Gjykata e Apelit vendosi në favor të tij, duke anuluar vendimin e AKKP-së, ndërsa Gjykata e Lartë e rrëzoi këtë vendim dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke argumentuar mungesë provash për pronësinë dhe duke konsideruar se vendimi i KVKKP-së nuk ishte i formës së prerë. Në 2016, Kolegji i Gjykatës vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim dhe pretendimet e ngritura si haptazi të pabazuara.

Në vitin 2024, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi shkeljen e parimit të sigurisë juridike (neni 6 i KEDNJ), pasi Gjykata e Tiranës dhe Gjykata e Lartë kishin anuluar pa arsye thelbësore dhe detyruese një vendim të formës së prerë për kthimin e pronës, atë të KVKKP-së Gjirokastrë, arsye për të cilën çështja duhej rihapur dhe rishqyrtuar.

Ndërkohë kërkuesi në atë proces, ndërroi jetë dhe trashëgimtarët e tij kërkuan rihapjen e procesit përpara kësaj Gjykate.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka evidentuar se rihapja e procesit kushtetues mund të kërkohet vetëm kur cenimi i konstatuar nga gjykata ndërkombëtare ka ardhur si rrjedhojë e vendimit të mëparshëm të kësaj Gjykate. Në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar se, ndonëse GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së në drejtim të parimit të sigurisë juridike, ajo nuk ia ka atribuuar këtë cenim, vendimmarrjes së Kolegjit të Gjykatës, por vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, konkretisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, të cilat kanë disponuar për anulimin e vendimit të formës së prerë të KVKKP-së Gjirokastrë pa rrethana thelbësore dhe detyruese që justifikonin këtë masë. Për rrjedhojë, Gjykata ka çmuar se kërkueset nuk legjitimohen racione materiae, në kuptim të nenit 71/c, pika 3, të Ligjit Organik të saj, për të kërkuar rihapjen e procesit kushtetues.

Nga ana tjetër, Gjykata ka çmuar se, në thelb, kërkesa lidhet me rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 494, paragrafi 2, shkronja “ë”, të KPC-së. Në këto rrethana, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje efektive të të drejtave themelore të kërkueseve dhe së drejtës së tyre për një mjet juridik efektiv për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja, çështjen objekt gjykimi Gjykata ia ka dërguar për shqyrtim gjykatës kompetente, pra Gjykatës së Lartë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës për rihapjen e procesit kushtetues dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Një gjyqtar u shpreh me mendim pakice, kundër dërgimit të çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.



**Procesi i rregullt ligjor -
E drejta për t'u gjykuar
nga një gjykatë e
paanshme**

FIALË KYÇE

Komisioni i Licencave/ përjashtim nga procedurat e prokurimit publik/ pezullim i përkohshëm i licencës/ paanshmëria në gjykim/ heqje dorë

Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi nga vetë gjyqtarja, pavarësisht se në prani të të njëjtit shkak mbi të cilin ajo kishte vepruar ndryshe në një çështje tjetër të kërkuases të lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, është e tillë që vë në dyshim paanshmërinë e saj, qoftë edhe në dukje.

Duke qenë se parimi i paanshmërisë në aspektin objektiv dikton dhënien e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimet prej saj (gjykatës) të çdo dyshimi në këtë drejtim, pjesëmarrja e gjyqtares E.M. në shqyrtimin e çështjes së kërkuases në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë lë vend për dyshime të arsyeshme në drejtim të paanshmërinë së saj në aspektin objektiv.

Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj, procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre rrjedhimisht argumentet e pamjaftueshme të kërkuases bëjnë që pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për gjykim të paanshëm të jetë i pabazuar.

Shoqëria "Geci" sh.p.k.

Për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë

Vendimi nr. 19, datë 24.02.2026

Faktet

Kërkuësja është person juridik, me objekt të veprimtarisë ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale etj., dhe, për kategori të ndryshme të punimeve të ndërtimit ajo është pajisur me licencë nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale (Komisioni i Licencave) në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT). Për shkak të gjetjeve dhe konstatimeve për deklarim të rremë në segmentin rrugor Dragobi-Valbonë, ministri i MPPT-së ka kërkuar nga Komisioni i Licencave nisjen e procedurave për dhënie mase administrative ndaj kërkuases. Në kuadër të kësaj procedure administrative, Komisioni i Licencave, me vendimin nr. 23, datë 15.11.2010 (vendimi nr. 23/2010), ka vendosur ndaj kërkuases masën administrative të heqjes të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit për një kohë prej 3 vjetësh, për kategoritë: NP-4, rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha etj. Në vijim, Drejtoria e Licencimit pranë MPPT-së ka njoftuar kërkuesen për pezullimin e përkohshëm të kategorive të licencës, duke i bërë të ditur se licenca saj është e pavlefshme. Kundër këtij vendimi kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 23/2010 të Komisionit të Licencave. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në gjykim. Më pas, kërkuësja ka marrë pjesë në disa procedura prokurimi të zhvilluara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) për rikonstruksion rrugësh, dhe me pretendimin se, ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët sesa operatorët e shpallur fitues, i ka kërkuar arsyet e mosshpalljes fituese dhe përse nuk është njoftuar për lidhjen e kontratës. FSHZH-ja i ka kthyer përgjigje se Komiteti i Vlerësimit ka refuzuar ofertat e saj duke konsideruar se ajo nuk ka përmbushur kriterin e kualifikimit për shkak të mosperformancës së saj dhe të çështjeve gjyqësore të pazgjidhura. Kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e MPPT-së t'i paguajë dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar, si rezultat i pezullimit të përkohshëm të licencës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, MPPT-së, të dëmshpërblente kërkuesen. Pas ankimit të paraqitur nga MIE-ja dhe Avokatura e Shtetit, Gjykata e Apelit, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë për sa i takonte kërkimit për pagimin e interesave. Pas rekursit nga MIE-ja dhe Avokatura e Shtetit, e kundërrekursit nga kërkuësja, Gjykata e Lartë, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të dy gjykatave, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuases, pasi ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat e faktit, padia e kërkuases është parashkruar, pasi është paraqitur tej afatit 3-vjeçar.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të paanshmërisë - Gjykata në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, për rrjedhojë, kërkesa u konsiderua e rrëzuar.

Sipas njërës qëndrim, u vlerësua se shkak për të cilin vihet në dyshim paanshmëria e gjyqtares E.M. lidhet me ekzistencën e arsyeve serioze të njëanshmërisë për shkak të njohjes familjare të saj me ortakun e vetëm dhe administratorin e kërkuases. Rezultoi se çështja objekt shqyrtimi në të cilën gjyqtarja E.M. ka qenë relatores në Gjykatën e Lartë është e lidhur me çështjen për të cilën ajo hoqi dorë nga gjykimi në shkallë të parë, për shkak se, ndërsa gjykimi në shkallë të parë kishte të bënte me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Licencave që kishte pezulluar licencën e kërkuases, gjykimi në Gjykatën e Lartë (objekt shqyrtimi) kishte të bënte me kërkimin e dëmit jashtëkontraktor, të shkaktuar pikërisht nga pezullimi i përkohshëm i licencës.

Sipas qëndrimit tjetër, shkak i paraqitur nga kërkuësja nuk është fakt bindës për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares relatores në Gjykatën e Lartë, ndaj vlen prezumimi i paanshmërisë së saj. Rezultoi se: (i) vetë kërkuësja nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares relatores nga trupi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka marrë njoftim rregullisht për përbërjen e trupit gjyqësor; (ii) rrethana e njohjes familjare është e ndryshme nga ajo e armiqësisë, në kuptim të nenit 72, pika 3, të KPC-së, ndaj nga pikëpamja logjike paanshmëria e gjyqtares duhet të vihej në dyshim nga pala kundërshtarë në gjykim e kërkuases dhe jo nga kjo e fundit; (iii) rrethana e njohjes familjare është deklaruar në vitin 2010, kur ajo ushtronte detyrën e gjyqtares në shkallë të parë, pra përpara 14 vjetëve.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës.



Parimi i prezumimit të pafajësisë -Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FIALË KYÇE

DRSSH-ja/ periudhë sigurimi/ dyshim i arsyeshëm/ mashtrim në sigurime/ masë dënimi/ parimi in dubio pro reo/ barra e provës/ aktet shkresore

Barra e provës për ekzistencën e elementeve të veprës penale rëndon mbi organin e prokurorisë, ndërsa gjykata e apelit nuk ka analizuar nëse dokumentacioni arkivor i ndërmarjes është i plotë dhe i besueshëm, sidomos në kushtet kur gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ky dokumentacion rezultoi i paplotë. Ekzistenca e një dyshimi për plotësinë ose mangësinë e arkivit nuk mund të interpretohet në disfavor të kërkuësës, pasi një dyshim i tillë, në dritën e parimit in dubio pro reo, duhet të shkojë në favor të saj. Gjykata e Lartë ka mbajtur një qasje formaliste, pa analizuar nëse standardi kushtetues i provueshmërisë së fajësisë dhe rregullat mbi barrën e provës janë respektuar nga ana e gjykatës së apelit.

Shadije Lika

Proces penal për mashtrim me sigurimet

Vendimi nr. 20, datë 24.02.2026

Faktet

Kërkuesja u akuzua për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” bazuar në kallëzimin penal të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Dibër, me pretendimin se kërkuesja nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara kishte përfituar pension në mënyrë të padrejtë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër pushoi çështjen penale, me arsyetimin se ndjekja penale nuk duhet të fillonte për shkak se kërkuesja nuk e kishte konsumuar veprën penale nga ana objektive. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi ndryshimin e vendimit, deklarimin fajtor të kërkuësës për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” si dhe dënimin e saj me 100.000 lekë gjobë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk kishte çmuar provat në kuptim të nenit 152 të KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuësës pasi nuk përmbante shkaqe ligjore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata e apelit nuk rezultoi të ketë analizuar faktin nëse prokuroria ka provuar se kërkuesja, për përfitimin e pensionit, kishte përdorur dokumente me përmbajtje të pavërtetë, konkretisht librezën e punës dhe vërtetimin e Ndërmarrjes Likuidatori të NFP-së, Krastë. Sipas Gjykatës dokumentet e paraqitura nga kërkuesja dhe dokumenti i prejardhur i paraqitur nga prokuroria (vërtetimi i DRSSH-së se kërkuesja ka punuar në një kooperativë tjetër) përbëjnë dokumente zyrtare me fuqi të plotë provuese deri në provimin e së kundërtës. Në këtë kuptim, kërkuësja është ngarkuar, në mënyrë të nënkuptuar, barra për të provuar pavërtetësinë e dokumentit të prejardhur të lëshuar nga institucionet përkatëse ose për të vërtetuar më tej ekzistencën e marrëdhënies së punës. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se gjykata e apelit ka bërë një çmuarje të drejtë të provave dhe një interpretim të saktë të ligjit, duke e konsideruar çështjen si të lidhur me vlerësimin e provave dhe, për rrjedhojë, jashtë kontrollit të tij rishikues ekskluzivisht ligjor. Gjykata vlerësoi se, duke mos mbajtur një qëndrim të shprehur dhe substancial për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, në veçanti lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe ndalimin e përmbysjes së barrës së provës, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur standardin e arsyetimit të vendimit.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.